EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5691
E premte, 1 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Admirali Foggo njoftohet me tranzicionin e FSK-së

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI HASHIM THAÇI, KRYEPARLAMENTARI KADRI VESELI DHE KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ JANË TAKUAR ME AMBASADORIN AMERIKAN NË KOSOVË, PHILIP KOSNETT

FAQE 4-5

Thaçi: Pres vendimmarrje në interes shtetëror

As të enjten nuk është arritur pajtueshmëri në mes të liderëve shtetërorë për heqjen e taksës ndaj produkteve të Serbisë dhe të Bosnjës. Në këtë aspekt nuk ka pasur sukses as takimi i përbashkët i krerëve shtetërorë me ambasadorin amerikan Philip Kosnett. Pavarësisht prej kërkesave të ShBA-së, kryeministri Ramush Haradinaj mbetet një prej udhëheqësve të vetëm të institucioneve që po e kundërshton pezullimin e taksës. Pas takimit me ambasadorin amerikan, presidenti Hashim Thaçi ka bërë me dije se në ditët e ardhshme pret vendimmarrje të përgjegjshme në përputhje të plotë me interesat shtetërore pasi, sipas tij, Kosova nuk ka kohë për të humbur

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka pritur në takim një delegacion të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Limaj: Marrëveshjet Kosovë - Shqipëri kanë nisur të zbatohen edhe në praktikë

Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, njëherësh koordinator kombëtar për mbikëqyrjen dhe për zbatimin e marrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, ka deklaruar të enjten se marrëveshjet Kosovë - Shqipëri, të arritura në mbledhjen e Pejës, kanë nisur të zbatohen edhe në praktikë. Ai ka thënë se kjo tregon se mbledhjet e të dy qeverive nuk janë thjesht politike dhe publike FAQE 3

Qytetarët dhe institucionet, të rrezikuar nga keqpërdorimi i sistemit të të dhënave

FAQE 7

AKTUALE

MËSUESI JETISH, FLAKADAN I KARADAKUT QË S'SHUHET KURRË...

F. 12

Shkruan: Faton BISLIMI

ZAHIRI, HAKIFI DHE EDMONDI KISHIN VIZION TË QARTË PËR LIRI DHE PAVARËSI

F. 8

51 SHTËPI DO TË NDËRTOHEN NË MITROVICË

F. 8

EKONOMI

DORËZOHET APLIKACIONI PËR STATUSIN E INVESTITORIT STRATEGJIK PËR 'GRAND HOTEL'

F. 9

OEAK-U, MF-ja DHE ATK-ja DISKUTOJNË PËR ÇËSHTJET E SEKTORIT TË PRODHIMIT

F.9

KULTURË

MINISTRI GASHI: VITI 2019 DO TË JETË VIT I STABILITETIT TË TEATROVE TË QYTETEVE

F. 8

SPORT

BËHET KATEGORIZIMI I SPORTEVE, SPORTISTËVE DHE TRAJNERËVE

F. 16

VALDET RAMA PREZANTOHET TE KUKËSI

F. 16

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Xhaferi për herë të parë e drejton seancën e Kuvendit në gjuhën shqipe

Shkup, 31 janar - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, e ka drejtuar seancën e parë në gjuhën shqipe në Kuvend. Xhaferi sqaroi, në një takim paraprak me gazetarët, se Ligji për përdorimin e gjuhëve siguron afat gjashtëmujor për përkthimin e materialeve të tjera të Kuvendit, përfshirë edhe emërtimet në institucionin ligjvënës. Shqipja, siç shpjegon televizioni "ALSAT", në emërtimet e Kuvendit do të aplikohet bashkë me ndryshimet e emrit të ri të vendit. Por, ky moment nuk kaloi pa kundërshtimin e VMRO-DPMNE-së, e cila këmbënguli se drejtimi i seancave në shqip është në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit dhe se bëhet për të fituar pikë politike pikërisht në prag të procesit zgjedhor. "Sot bëhemi përsëri dëshmitarë të mënyrës se si nxitoni, duke i shkelur procedurat, ta vendosni Ligjin për dygjuhësinë në funksion, vetëm për një votë më shumë dhe për marketing ditor politik", tha Nikola Micevski, koordinator i grupit parlamentar të partisë më të madhe të opozitës.

Duke u përpjekur të sqarojë këtë çështje, Xhaferi u shpreh se, fakti që ligjet e tjera dhe Rregullorja e Kuvendit nuk janë përshtatur ende me Ligjin e gjuhëve, nuk e pengon zbatimin e tij në Kuvend.

Inteligjenca amerikane: Ballkani Perëndimor, në rrezik nga ndonjë konflikt ushtarak

Në raportin e Komunitetit të Inteligjencës së ShBA-së thuhet se Rusia do të tentojë t'i shfrytëzojë tensionet etnike në Ballkan dhe korrupsionin që është në nivele të larta, për ta penguar rrugën euroatlantike të vendeve të këtij rajoni

Uashington, 31 janar - Mundësia e një konflikti të hapur ushtarak dhe ndikimi i Rusisë mbeten kërcënimet kryesore për sigurinë e Ballkanit Perëndimor për vitin 2019, thuhet në një raport të Komunitetit të Inteligjencës së ShBA-së rreth vlerësimit të kërcënimeve në botë për vitin 2019. Sipas këtij raporti, Rusia do të tentojë t'i shfrytëzojë tensionet etnike në Ballkan dhe korrupsionin që është në nivele të larta, për ta penguar rrugën euroatlantike të vendeve të këtij rajoni. "Ballkani Perëndimor, pothuajse me siguri do të mbetet ende në rrezik për të pasur dhunë të nivelit të ulët dhe, ndoshta, të ndonjë konflikti të hapur ushtarak gjatë vitit 2019. Rusia do të kërkojë t'i shfrytëzojë tensionet etnike dhe nivelet e larta të korrupsionit për t'i penguar vendet e këtij rajoni që të lëvizin drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe NATO", thuhet në raport.

Sipas raportit, grupi militant Shteti Islamik dhe organizata terroriste Al-Kaida vazhdojnë të konsiderohen rrezik për sigurinë në botë. Në raport thuhet se grupi militant Shteti Islamik ende urdhëron mijëra luftëtarë në Siri dhe Irak dhe ka mijëra mbështetës nëpër botë, pavarësisht prej humbjeve që ka pësuar në territor. Sipas raportit, ISIS-i me shumë gjasë do të vazhdojë të kryejë sulme jashtë territorit të Irakut dhe Sirisë kundër kundërshtarëve rajonalë dhe perëndimorë, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

"ISIS-i po kryen sulme në Irak dhe Siri për t'i minuar përpjekjet e stabilizimit dhe për t'u hakmarrë kundër armiqve të saj, duke shfrytëzuar tensionet mes sekteve në të dy këto vende. Në vlerësojmë se ISIS-i do të kërkojë ta shfrytëzojë situatën duke përfshirë pakënaqësitë sunite, paqëndrueshmërinë shoqërore dhe mungesën e shtrirjes së forcave të sigurisë, për të rifituar territor në Siri dhe Irak, për një afat më të gjatë", thuhet në këtë raport. Një pjesë e këtij raporti flet edhe për kërcënimin që mund të vijë nga organizata Al-Kaida. Kjo organizatë, sipas këtij raporti, mbetet një sfidë për Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj për vitin e ardhshëm.

Rama e Boltoni bisedojnë edhe për marrëveshjen Kosovë - Serbi

Tiranë, 31 janar - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka zhvilluar një bisedë telefonike me John Bolton, këshilltarin kryesor për sigurinë kombëtare të presidentit amerikan, Donald Trump. Kreu i ekzekutivit shqiptar, Edi Rama, të enjten ka zhvilluar një bisedë telefonike me John Boltonin, këshilltarin kryesor për sigurinë kombëtare të presidentit amerikan, Donald Trump. Përmes një postimi në profilin e tij zyrtar në rrjetin social "Facebook", Rama thotë se me Boltonin bisedoi edhe për marrëveshjen Kosovë - Serbi.

"Bisedë me Shtëpinë e Bardhë. Në fokus Shqipëria, rajoni dhe objektivi strategjik për një marrëveshje paqeje në mes të Kosovës e Serbisë, që ta mbyllë konfliktin historik. Këshilltari për sigurinë, J. Bolton, më falënderoi në emër të presidentit Trump për qëndrimet konsekuente të Shqipërisë", ka shkruar Rama në "Facebook".

Basha: Prokuroria meriton grushtin e protestës

Tiranë, 31 janar - Kreu i PD-së, Lulzim Basha, i është bashkuar të enjten pasdite protestës së Unazës së re bashkë me banorët e zonës së "Astirit" që Qeveria Rama kërkon t'u rrëzojë banesat. Veç akuzave ndaj Ramës, Basha ka sulmuar edhe Prokurorinë për moshetimin e aferës korruptive. "Po asistojmë në një farsë totale. Prokuroria duhet t'i çojë në burg politikanët e kapur në flagrancë, duke blerë e shitur vota. Me aktin e sotëm ku ajo shqetësohet për nxjerrjen e sekretit nga "Zëri i Amerikës", prokuroria meriton grushtin më të fuqishëm më 16 shkurt, njësoj si Edi Rama dhe Erion Veliaj", tha Basha.

Kreu i PD-së deklaroi se banorët e unazës rezistuan dhe treguan korrupsionin më të madh nga Qeveria. "Përshëndes banorët e Unazës për qëndresën e

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka pritur në takim një delegacion të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Limaj: Marrëveshjet Kosovë - Shqipëri kanë nisur të zbatohen edhe në praktikë

Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, njëherësh koordinator kombëtar për mbikëqyrjen dhe zbatimin e marrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, ka deklaruar të enjten se marrëveshjet Kosovë - Shqipëri, të arritura në mbledhjen e Pejës, kanë nisur të zbatohen edhe në praktikë. Ai ka thënë se kjo tregon se mbledhjet e të dy qeverive nuk janë thjesht politike e publike

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 31 JANAR - Zëvendëskryeministri, njëherësh koordinator kombëtar për mbikëqyrjen dhe zbatimin e marrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se marrëveshjet Kosovë - Shqipëri kanë nisur të zbatohen edhe në praktikë. Teksa ka pritur në takim një delegacion të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të kryesuar nga ministri i Brendshëm, Sander Lleshaj, dhe përfaqësues të tjerë nga institucionet e Shqipërisë, Limaj është shprehur i kënaqur që vendimet, të cilat janë marrë në mbledhjen e dy qeverive të mbajtur në muajin nëntor në Pejë, kanë nisur të jetësohen në praktikë. Në të njëjtën kohën, ai ka vlerësuar se të dy qeveritë po angazhohen në funksion për jetësimin e plotë të të gjitha marrëveshjeve të arritura mes dy vendeve. "Kjo tregon se takimet e përbashkëta Kosovë-Shqipëri nuk janë thjesht politike e publike, siç janë komentuar, por kemi kaluar në veprime konkrete të cilat kanë për objektiv mirëqenien, lehtësimin e qarkullimit të qytetarëve, integrimin", ka thënë Limaj.

Në këtë takim të dy kabinetet janë njoftuar me të arriturat për vendosjen e pikës Doganore të Kosovës në Portin e Durrësit, pastaj për fillimin e zbatimit të marrëveshjes për heqjen e çmimeve të shërbimeve roaming si dhe për kryerjen e veprimtarive të kontrollit doganor në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Morinë - Vërmicë.

Zëvendëskryeministri Limaj ka paralajmëruar se takimet do të vazhdojnë edhe në të ardhmen deri në jetësimin e plotë të marrëveshjeve.

Më 15 janar Limaj kishte marrë pjesë në hapjen e Zyrës Doganore të Kosovës në Durrës, veprim ky që është cilësuar si projekti më i rëndësishëm konkret në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, pas ndërtimit të Rrugës së Kombit. Hapja e Zyrës Doganore të Kosovës në Durrës ka qenë marrëveshja e dytë që është zbatuar, kurse vendimi i parë që është zbatuar ka qenë integrimi i kufijve që ka filluar këtë vit dhe që do përfundojë tërësisht në muajin mars.

Qeveritë e dy shteteve shqiptare, Shqipërisë dhe Kosovës, në mbledhjen e përbashkët në Pejë, kanë nënshkruar nëntë marrëveshje bashkëpunimi. Në takimin e së enjtes nga Qeveria e Kosovës, pjesëmarrës ishin ministri i Brendshëm, Ekrem Mustafa, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, zëvendësministri i Bujqësisë, Vesel Krasniqi, drejtori i Doganës, Bahri Berisha, si dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Rashit Qalaj.

Edhe infermierët të pakënaqur me Projektligjin për pagat

PRISHTINË, 31 JANAR - Infermierët e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës kanë protestuar të enjten në shenjë pakënaqësie ndaj projektligjit për paga. Rangimi i infermierëve në këtë projektligj, sipas tyre, është i patolerueshëm. Kjo protestë, e cila është mbajtur në hapësirën e QKUK-së në Prishtinë, është përkrahur edhe nga Federata Sindikale e Shëndetësisë dhe Oda e Infermierëve.

Projektligji për pagat, i cili pritet të shqyrtohet për miratim në Kuvendin e Kosovës më 2 shkurt, ka shpërfaqur pakënaqësi sociale në shumë sektorë publikë në Kosovë. Institucionet arsimore tashmë kanë hyrë në javën e tretë të grevës, duke insistuar në kërkesën e tyre për rritjen e koeficientit të pagës për 30 për qind.

Në grevë për më shumë se një muaj janë edhe mjekët kirurgë në Kosovë. Përveç këtyre, pakënaqësi kanë shprehur edhe rreth 22 mijë shërbyes civilë në administratën lokale dhe qendrore, të cilët kërkojnë nivelim të pagave me sektorët e tjerë publikë. (rel)

Presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj janë takuar me ambasa

Thaçi: Pres vendimmarrje

As të enjten nuk është arritur pajtueshmëri në mes të liderëve shtetërorë për heqjen e taksës ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës. Në këtë aspekt nuk ka pasur sukses as takimi i përbashkët i krerëve shtetërorë me ambasadorin amerikan, Philip Kosnett. Pavarësisht prej kërkesave të ShBA-së, kryeministri Ramush Haradinaj mbetet një prej udhëheqësve të vetëm të institucioneve që po e kundërshton pezullimin e taksës. Pas takimit me ambasadorin amerikan, presidenti Hashim Thaçi ka bërë me dije se në ditët e ardhshme pret vendimmarrje të përgjegjshme në përputhje të plotë me interesat shtetërore pasi, sipas tij, Kosova nuk ka kohë për të humbur

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 31 JANAR - Pajtueshmëri për heqjen e taksës nuk ka sjellë të enjten as takimi i përbashkët i liderëve shtetërorë, presidentit Hashim Thaçi, kryeparlamentarit Kadri Veseli, kryeministrit Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministrit Fatmir Limaj dhe zëvendëskryeministrit Behgjet Pacolli me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Philip Kosnett. Ky i fundit nuk ka qëndruar shumë dhe ka dalë nga takimi me liderët shtetërorë dhe nuk është deklaruar as për media. Ndërkaq takimi në mes të liderëve të shtetit ka vazhduar edhe pa praninë e ambasadorit amerikan. Pas takimit në Presidencë, Haradinaj, Limaj dhe Pacolli kanë zhvilluar edhe një takim të përbashkët në Qeveri, ku pjesë e këtij takimi ishte edhe kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka njoftuar rreth takimit që ka pasur me ambasadorin amerikan në Kosovë, Philip Kosnett dhe liderët institucionalë. "Sot, në prani të ambasadorit amerikan në Kosovë, Philip S. Kosnett, kam zhvilluar takime të përbashkëta me liderët institucionalë, me kryeparlamentarin Kadri Veseli, kryeministrin Ramush Haradinaj dhe zëvendëskryeministrat Fatmir Limaj e Behgjet Pacolli. Në këto takime kemi biseduar për çështje të rëndësishme shtetërore, për ruajtjen e partneritetit të përjetshëm me ShBA-në dhe për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Interesi shtetëror duhet të bëjë bashkë gjithë spektrin politik, për të marrë vendime të rëndësishme për perspektivën e qytetarëve dhe për të ardhmen tonë euroatlantike, në përputhje me interesat e ShBA-së dhe partnerëve strategjikë të Kosovës. Prandaj, në ditët në vijim pres vendimmarrje të përgjegjshme në përputhje të plotë me interesat shtetërore. Nuk kemi kohë për të humbur", ka thënë Thaçi.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike, ka thënë se partneriteti i Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të jetë i përjetshëm. "I gjithë orientimi dhe përpjekja jonë është e qartë dhe e drejtë, ta mbrojmë atë që e kemi arritur deri më sot, shtetin tonë të pavarur dhe sovran dhe do t'i ruajmë partnerët tanë strategjike ShBA-në dhe partnerët tanë perëndimorë. Kjo është ajo që kemi bërë. Qytetarët duhet të ndihen të sigurt se shteti dhe sovraniteti mbrohen përmes politikave të mençura dhe të qarta ndërkombëtare të cilat jemi duke i mbajtur. Në të njëjtën kohë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë vetë Kosova. Ne jemi një, aty ku është Amerika është edhe Kosova", ka deklaruar Veseli, duke shtuar se sovraniteti dhe shteti nuk mbrohen pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partnerët ndërkombëtarë. "I rëndësishëm është partneriteti me ShBA-në dhe i gjithë orientimi im politik është drejt kombit tim dhe fuqizimit të kombit tonë me ShBA-në. Nuk ka sovranitet dhe mbrojtje të territorit të Kosovës pa

ıdorin amerikan në Kosovë, Philip Kosnett

në interes shtetëror

politika të mençura euroatlantike, pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partnerët ndërkombëtarë", është shprehur Veseli. Ai ka vlerësuar se pak kanë rëndësi karriget e drejtuesve të institucioneve, kur është në pyetje shteti dhe ruajtja e partneritet me ata të cilët e kanë mundësuar lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Veseli ka ripërsëritur qëndrimin e tij se Mitrovica do të jetë një dhe se nuk do të ketë këmbim të territoreve dhe asociacion me kompetenca ekzekutive. "Mitrovica do të jetë një, nuk do të ketë Kosovë me asociacion me kompetenca ekzekutive, nuk do të ketë këmbim të territoreve, por do të ketë partneritet të përjetshëm me ShBA-në", ka theksuar Veseli.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka quajtur të pakuptimtë kushtëzimin e dialogut me heqjen e taksës. Sipas tij, vendosja e taksës është vendim sovran i Kosovës dhe nuk është bërë kundër dialogut, por që t'i kërkohet Serbisë një qasje e re në raport me Kosovën. "Ky është vendim sovran i Qeverisë së vendit dhe nuk e kuptoj pse këto tema ndërlidhen si janë ndërlidhur deri tani. Nëse ka vullnet të mirë për ta ndihmuar procesin e dialogut nuk është e vetmja mënyrë heqja e taksës. Nëse dëshirojmë ta ndihmojmë dialogun, atëherë të kërkohet vazhdimi i dialogut pa kushte, e në tavolinë të bisedohet për të gjitha, edhe për taksën, edhe për çfarëdo tjetër. Është i pakuptimtë kushtëzimi i dialogut me heqjen e taksës. Serbia ka marrë shumë vendime të brendshme. Asnjë nga to nuk ka qenë kusht që ne të mos shkojmë në tavolinë. Nëse Federica Mogherini dëshiron ta vazhdojë dialogun, le ta vazhdojë", ka deklaruar Haradinaj. Madje ai nuk e ka hedhur poshtë mundësinë për rrëzimin e qeverisë në ditët dhe javët në vijim. "Ne jemi në procese reale politike. Të gjitha janë të mundura në këto ditë dhe javë që vijnë. Dëshira ime është që këtë të shtunë t'i kryejmë disa detyra me interes për vendin siç është buxheti dhe mos t'i lëmë arsimtarët dhe të tjerët pa paga. Nëse mospajtimet politike vazhdojnë, mund të rezultojnë me të arritura të tjera, çfarëdo qofshin ato", është shprehur Haradinaj. Sidoqoftë, ai ka thënë se ka respekt për ambasadorin amerikan dhe ShBA-në, madje ai ka thënë se Amerika është familja e tij edhe kur nuk ndajnë mendime të njëjta me të. "Unë kam shumë respekt për ambasadorin amerikan dhe ShBA-në. Amerika për mua është familja ime edhe kur nuk ndaj mendim të njëjtë me të", ka deklaruar Haradinaj.

Limaj: Ndihemi krenarë që kemi bashkëpunuar me Haradin Balën

Në njëvjetorin e vdekjes e kujton një mik dhe një shok që kujtimi i ka bashkuar përmes luftës çlirimtare. "Sot jemi këtu të gjithë dhe ndihemi krenarë që kemi bashkëpunuar me atë burrë. Haradini ka pasur fatin që të rritet në një familje ku kultivoheshin urtësia dhe mençuria. Sado me situata të komplikuara, Haradini i ka kaluar e i ka thjeshtuar ato", ka thënë Limaj

Drenas, 31 janar (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka marrë pjesë të enjten në akademinë përkujtimore në njëvjetorin e vdekjes së veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Haradin Bala. Limaj me këtë rast ka thënë se ka pasur fatin që ta ketë një bashkëluftëtar si Haradin Bala. Ai ka thënë se në njëvjetorin e vdekjes e kujton një mik dhe një shok që kujtimi i ka bashkuar përmes luftës çlirimtare. "Sot jemi këtu të gjithë dhe ndihemi krenarë që kemi bashkëpunuar me atë burrë. Haradini ka pasur fatin që të rritet në një familje ku kultivoheshin urtësia dhe mençuria. Sado me situata të komplikuara, Haradini i ka kaluar e i ka thjeshtuar ato", ka thënë Limaj në akademinë e mbajtur në Drenas. Limaj ka porositur që kujtimi për dëshmorët të mos bëhet vetëm për ta kujtuar veprën e tyre, por edhe për t'i jetësuar amanetet e tyre. "Lufta na ka bashkuar siç na ka bashkuar, ndërsa marifeti i kësaj jete është se si do të shkojmë ne nga kjo jetë. Haradini është shembull në mënyrën se si ka shkuar", ka shtuar Limaj.

Së shpejti një rrugë në Drenas do të marrë emrin e Haradin Balës

Edhe kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka marrë pjesë në akademinë përkujtimore kushtuar Haradin Balës, duke theksuar kontributin e tij dhe të familjes Bala për çlirim. Lladrovci ka theksuar se së shpejti në Drenas, në shenjë nderimi për Haradin Balën, do të pagëzohet edhe një rrugë me emrin e tij. "Akademia përkujtimore në njëvjetorin e vdekjes së Haradin Balës ishte rast t'i ritheksoja vlerat e kësaj familjeje me dëshmi dhe përkushtim, me traditë, nga babai i Haradinit, Selmani dhe vëllai, Abedini, të cilët në kohët më të vështira i dolën zot vendit. Drenica ka dhënë shumë kontribut për rezistencë dhe luftë të armatosur deri në çlirim. Kontributi i Haradin Balës dhe familjes së tij do të mbesin të paharrueshëm ndër breza. Së shpejti në Drenas do ta pagëzojmë një rrugë me emrin e Haradin Balës si shenjë respekti ndaj tij", ka thënë Lladrovci.

Zahiri, Hakifi dhe Edmondi kishin vizion të qartë për liri dhe pavarësi

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj, kanë bërë të enjten homazhe te shtatorja e Zahir Pajazitit në Prishtinës, me rastin e 22-vjetorit të rënies heroike të Zahir Pajazitit, Hakif Zejnullahut dhe Edmond Hoxhës

EPOKA E RE Qendresa RAMA

Prishtinë, 31 janar - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka vlerësuar lart vizionin dhe guximin e tre heronjve të kombit, Zahir Pajazitit, Hakif Zejnullahut dhe Edmond Hoxhës. "Filluan rezistencën për liri dhe pavarësi, me një vizion dhe qëndrim shumë të qartë. Me guximin dhe vizionin e tyre bënë që të bashkohet gjithë populli i Kosovës, gjithë kombi dhe ta kemi përkrahjen edhe të bashkësisë ndërkombëtare. Sot bëjmë nderimet më të larta shtetërore për komandantët tanë, për bashkëluftëtarët tanë, duke treguar gjithmonë respekt institucional, duke vlerësuar dhe afirmuar vlerat e luftës për liri dhe pavarësi, në të njëjtën kohë duke marrë energji të reja në përkushtimet tona të ardhshme për integrim edhe në NATO, edhe në Bashkim Evropian dhe në fuqizimin e partneritetit të përjetshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka thënë presidenti Thaçi.

Ndërkaq kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se rënia e tre heronjve të 31 janarit të vitit 1997, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, ishte paralajmërim i një epoke të re në historinë e përpjekjeve tona të gjata për liri dhe pavarësi. "Ishte paralajmërim i Epokës së UÇK-së e cila po ngrihej për ta përmbushur ëndrrën tonë të madhe, ëndrrën për Kosovën e lirë dhe të pavarur. Sot ne kemi obligim ndaj të kaluarës sonë dhe fëmijëve të Kosovës që të mos lejojmë të zë vend në mesin tonë përçarja. Shteti ynë bëhet i fortë vetëm duke qenë të bashkuar në vizionin tonë për të ardhmen", ka thënë Veseli.

Kurse kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, duke kujtuar veprën e heroit Zahir Pajaziti, ka thënë se janë bërë 22 vjet, por porosia e heronjve edhe sot është e freskët. "Liria është e shtrenjtë, e çmueshme dhe do të kujdesemi që të jemi çdo herë në respekt të vlerave të lirisë sikur sot", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj të mërkurën mori pjesë edhe në Akademinë Përkujtimore në Junik, në 22-vjetorin e rënies së heronjve të kombit, Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu, në nderim të veprës së tyre.

Ish-ministrja Tahiri: Ndryshimi i kufijve, skenar i rrezikshëm për Kosovën dhe rajonin

Prishtinë, 31 janar (ER) - Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka bërë një shkrim në llogarinë e vet në "Facebook", për takimin që pati para disa ditësh me presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta. Tahiri ka potencuar se takimi me presidentin Meta ishte thellësisht kombëtar dhe vizionar, sidomos qëndrimi i tij në mbrojtje të shtetit të Kosovës dhe kufijve. "Takimi me presidentin Ilir Meta ishte thellësisht kombëtar dhe vizionar. Qëndrimet e tij në mbrojtje të shtetit të Kosovës dhe kufijve ishin qëndrime të drejta të një presidenti shqiptar që njeh mirë luftën dhe sakrificat më sublime të shqiptarëve dhe Kosovës për liri dhe pavarësi. U pajtuam që ndryshimi i kufijve në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë është një skenar i rrezikshëm që dëmton shtetin e Kosovës dhe interesat kombëtare si dhe destabilizon rajonin me pasoja të paparashikueshme", ka shkruar Tahiri. Ajo ka thënë se Kosova është bërë shtet i pavarur dhe sovran falë aleatëve perëndimorë. "Kosova është shtet i pavarur dhe sovran me kufij të pacenueshëm në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, të cilën e ka vërtetuar Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësi në vitin 2010. Kosovën e bëmë shtet falë luftës sonë të drejtë dhe mbështetjes nga aleatët tanë perëndimorë në krye me ShBA-në, partnerët evropianë Gjermaninë, Mbretërinë e Bashkuar etj., NATO-n. Nderi ynë kombëtar të cilën e rikthyem me luftën e fituar për liri dhe gjeopolitika perëndimore së cilës i takon kombi shqiptar, qofshin të përjetshme!", ka shkruar ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri.

Admirali Foggo njoftohet me tranzicionin e FSK-së

Admirali i Marinës së ShBA-së, James Gordon Foggo III, në takimet që ka pasur të enjten me përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, është njoftuar nga afër me tranzicionin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë theksuar se ky tranzicion është i koordinuar me KFOR-in dhe NATO-n

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 JANAR - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, dhe kryeministri Ramush Haradinaj, e kanë pritur në takime të ndara admiralin e Marinës së ShBA-së, James Gordon Foggo III, i cili shërben si Komandant i Forcave të Marinës së ShBA-së për Evropë.

Presidenti Thaçi i ka thënë admiralit amerikan se Kosova është e përkushtuar për paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm. "Po punojmë që të krijohen kushtet për të vazhduar dialogu, si mënyrë e vetme për paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm. U jemi mirënjohës për përkushtimin tuaj për ruajtjen e paqes në Kosovë dhe rajon", u shpreh Thaçi.

Presidenti Thaçi dhe admirali James Foggo kanë folur edhe për tranzicionin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, i cili është proces i koordinuar me KFOR-in dhe NATO-n.

Ndërsa admirali i marinës së ShBA-së, James Gordon Foggo III, ka theksuar se dialogu është rruga e vetme që çon përpara. "KFOR-i do të vazhdojë të ofrojë paqe dhe siguri", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi ka thënë se viti 2019 është shpallur vit i NATO-s në Kosovë për të kujtuar dhe nderuar përkushtimin dhe sakrificën e ushtarëve të shteteve të NATO-s për Kosovën.

Admirali i Marinës së ShBA-së, James Gordon Foggo, gjatë takimit me kryeministrin Ramush Haradinaj, ka thënë se misioni i KFOR-it mbetet i pandryshuar për një mjedis të sigurt në Kosovë dhe për ruajtjen e stabilitetit në Kosovë dhe rajon.

Ndërkaq kryeministri Haradinaj e ka njoftuar admiralin Foggo për zhvillimet aktuale politike dhe të sigurisë në Kosovë, duke e falënderuar atë dhe NATO-n për mbështetjen e Kosovës në të gjitha proceset dhe për misionin e tyre për krijimin dhe forcimin e paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe më gjerë. "U jemi mirënjohës përjetësisht për angazhimin dhe rolin tuaj dhe të gjithë ushtarëve të KFOR-it, të cilët kanë shërbyer dhe vazhdojnë të shërbejnë për të krijuar një ambient të qetë dhe të sigurt për qytetarët e Kosovës", ka deklaruat kryeministri Haradinaj, duke e siguruar atë se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për bashkëpunim me KFOR-in për forcimin e stabilitetit dhe të sigurisë në Kosovë dhe rajon.

Duke konfirmuar bashkëpunimin e të gjitha institucioneve të sigurisë të Kosovës me KFOR-in, kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova do ta ruajë dhe forcojë partneritetin me NATO-n. "Ne jemi popull që u takojmë popujve të lirë, të udhëhequr nga ShBA-ja, në shërbim të paqes në vend, rajon dhe botë", ka thënë Haradinaj në takim, duke shtuar se Kosova është e gatshme t'i bashkohet NATO-s në misionet paqësore, në shërbim të paqes dhe sigurisë në botë.

Edhe kryeministri Haradinaj e ka njoftuar admiralin Foggo për periudhën e tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke thënë se kjo forcë do të jetë shumetnike, profesionale dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit, në të cilën do të jenë të përfshira të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Qytetarët dhe institucionet, të rrezikuara nga keqpërdorimi i sistemit të të dhënave

PRISHTINË, 31 JANAR (ER) - Zhvillimi i hovshëm i epokës digjitale ka bërë që ta transformojë jetën e njerëzimit dhe ta shtojë numrin e përdoruesve të internetit, epokë e cila po paraqet edhe sfida të shumta për ruajtjen sigurisë dhe privatësisë. Për këtë arsye 28 janari, Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, e njohur edhe si Dita Ndërkombëtare e Privatësisë, shënohet si datë ku ekspertë të fushës organizojnë edhe fushata ndërgjegjësuese për t'i informuar qytetarët lidhur me të drejtat e tyre në mbrojtjen e të dhënave personale.

Me këtë rast, Kolegji UBT, në bashkëpunim me komitetin Cyber Security and Privacy, ka mbajtur trajnimin që ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave personale, shkeljen e privatësisë, si dhe masat që duhet të merren në rast se keqpërdorohen të dhënat. Mentor Hoxhaj nga Cyber Security and Privacy përmes shembujve praktikë ka treguar se duhet ndërgjegjësim në këtë aspekt ngaqë, sipas tij, zhvillimi teknologjik ka bërë që sot çdo komunikim në mbarë botën, në çdo formë, në çdo kohë, mund të monitorohet. Hoxhaj ka theksuar se operatorët telefonikë në Kosovë, veç policisë dhe shërbimeve inteligjente, kanë qasje në të gjitha informatat e klientëve të tyre. Kjo, sipas tij, përbën edhe shkelje ligjore. "Policia e Kosovës ka autoritet që të vendosi kamera në hapësira publike. Në atë kohë të dhënat të cilat janë ruajtur kanë qenë numri i telefonit i cili ka thirrur dhe koha e thirrjes. Ndërsa tash kemi mbi 40 të dhëna të cilat ruhen në momentin kur thërrasim dikë. Posta i ka dhënë linçet policisë dhe ia jep autoritetin t'i përgjojë thirrjet. Në bazë të ligjit, Ipko dhe Vala nuk do të duhej të dinin se kush po përgjohet. Kemi dy dhoma të përgjimit, ajo e Inteligjencës dhe e Policisë. Çdo klient i shërbimit të Valës mund të përgjohet nga Policia e Kosovës", ka thënë Hoxhaj.

Në kohën kur në botë, organet e ndryshme po bëjnë përpjeke për ta rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e mbrojtjes së të dhënave, në Kosovë, Mentor Hoxhaj ka potencuar se vetë zyra e kryeministrit të Kosovës dhe komunat e vendit nuk janë të mbrojtura në sistemin e të dhënave. Sipas tij, kjo mund ta rrezikojë edhe manipulimin e të dhënave të ndryshme. "Gjithnjë është dikush që është duke mbledhur informacione mbi ju. Zyra e kryeministrit dhe Komuna e Prishtinës janë të rrezikuar nga hakerët pasi ata nuk janë mjaftueshëm të mbrojtur", ka thënë Hoxhaj.

Nushi: Reformat në administratën e Prishtinës, shembull për komunat në rajon

Prishtinë, 31 janar (ER) - Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi, ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Vrapçishtit, Isen Shabani. Në këtë takim është diskutuar për reformat që janë zbatuar në Administratën e Prishtinës, projekte këto që kanë rezultuar të suksesshme si dhe me shërbime shumë të shpejta për qytetarë. Siç ka njoftuar Komuna e Prishtinës, Nushi ka thënë se reformat në administratën e Prishtinës janë shembull për komunat në rajon. "Ndër temat e diskutimit ishin digjitalizimi i shumë shërbimeve, menaxhimi i radhëve, e-Kiosku dhe projekte të ngjashme që kanë ndikuar dukshëm në rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. Komuna e Prishtinës është e gatshme që përvojën e vet në qeverisje të mirë ta shpërndajë sa më shumë në komunat shqiptare, në mënyrë që përmes projekteve që kanë rezultuar të suksesshme në Prishtinë të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës të qytetarëve në komunat e tyre", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.

Ministri Gashi: Viti 2019 do të jetë vit i stabilitetit të teatrove të qyteteve

Prishtinë, 31 janar (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka takuar të enjten grupin punues për hartimin e Ligjit për teatrot, me të cilin ka diskutuar për rrjedhën e procesit, përmbajtjen që do të ketë ligji dhe si do të ndikojë ai në përmirësimin e funksionimit të teatrove nëpër qytetet e Kosovës dhe për avancimin e jetës kulturore në përgjithësi.

Ministri Gashi ka ofruar mbështetje të plotë për grupin punues për hartimin e ligjit.

Ministri u shpreh se pret nga grupi një punë intensive për përgatitjen e një ligji i cili do të funksionalizojë teatrot e qyteteve. "Komunave t'i mundësohet ndarja e mjeteve të nevojshme për teatrot e tyre si dhe të angazhohen aktorët e qyteteve në këto teatro", ka thënë Gashi. Ai ka thënë se me këtë ligj fuqizohen teatrot nëpër qytetet e Republikës së Kosovës si dhe do të ketë angazhim më të madh të aktorëve të qyteteve përkatëse nëpër këto institucione të kulturës.

Ministri ka konsideruar se viti 2019 do të jetë viti i kthesës së madhe për teatro, institucione të cilat nuk kanë pasur trajtim dhe mbështetje me dinjitet nga komunat e Kosovës. Ndërkaq, grupi punues u shpreh se do të hartojë një ligj i cili do të jetë një politikë e zbatueshme dhe që do të ndikojë në rritjen e aktiviteteve kulturore dhe ngritjen e vlerave të mirëfillta.

51 shtëpi do të ndërtohen në Mitrovicë

Mitrovicë, 31 janar (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të enjten në takim humanistin, njëkohësisht kryetarin e Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", Halil Kastratin, dhe bashkëpunëtorët e tij, me të cilët ka biseduar për bashkëpunimin me këtë shoqatë për ndërtimin e shtëpive për familjet që kanë nevojë. Qëllimi i këtij takimi ishte të nënshkruhej një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Komunës së Mitrovicës dhe Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" për realizimin e projektit për ndërtimin e 40 shtëpive për familjet skamnore të cilat nuk e kanë të zgjedhur çështjen e strehimit.

Nëpërmjet kësaj marrëveshje Komuna e Mitrovicës do të participojë me mjete financiare në shumë totale prej 200 000 mijë eurosh si dhe ka siguruar pronën komunale për ndërtimin e të gjitha shtëpive për familjet në nevojë.

Kryetari Bahtiri ka vlerësuar kontributin e shoqatës dhe angazhimin e humanistit Kastrati me bashkëpunëtorët e tij, duke thënë se shoqata e tyre vazhdimisht ka ndihmuar shumë familje të Mitrovicës me pako ushqimore, ka ndarë bursa për studentët e familjeve skamnore dhe ka ofruar ndihmë mujore financiare për fëmijët jetimë. Po ashtu, pjesë e këtij projekti do të jenë edhe Lindrit Misini, pronar i lokalit "Missini Sweets", së bashku me djemtë e Mitrovicës të cilët do të ndërtojnë 10 shtëpi për familjet që kanë nevojë.

Edhe kryetari Bahtiri gjatë këtij takimi ka theksuar se kësaj vepre madhështore të Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" dhe djemve të Mitrovicës do t'i bashkëngjitet edhe ai duke ofruar mjete financiare për ndërtimin e një shtëpie nga buxheti i tij. Me këtë rast, kryetari Bahtiri dhe humanisti Kastrati u pajtuan që bashkëpunimin mes Komunës dhe Shoqatës "Jetimat e Ballkanit" ta ngrehin në nivel institucional, në mënyrë që të përfshihet një numër sa më i madh i familjeve në nevojë.

Miratohet rregullorja e re për ndarjen e bursave në Therandë

Therandë, 31 janar (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se Kuvendi Komunal ka miratuar Rregulloren për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë të kësaj komune. "Dje në mbledhjen e Asamblesë Komunale janë marrë disa vendime të rëndësishme. Ndër to u votua edhe pro Rregullores së re për ndarjen e bursave për nxënës dhe studentë. Ajo u plotësua edhe me disa kërkesa që u dhanë nga përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike, të cilët i falënderoj për bashkëpunimin. Mendoj se kemi bërë më të mirën, duke shërbyer me drejtësi dhe korrektësi ndaj atyre që në të ardhmen do t'i shërbejnë vendit", ka thënë Muharremaj.

Dorëzohet aplikacioni për statusin e investitorit strategjik për 'Grand Hotel'

PRISHTINË, 31 JANAR (ER) - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, të enjten ka pritur në takim presidentin e kompanisë "Global Hotel Investments AG", Roger Maibach, kompani kjo e cila, në partneritet me rrjetin më të madh të hoteleve në botë "Accor Hotels", ka dorëzuar aplikacionin për statusin e investitorit strategjik për "Grand Hotel"-in në Prishtinë.

Presidenti i "Global Hotel Investments AG", Roger Maibach, ka theksuar se ky rrjet i hoteleve së shpejti do të jetë i pranishëm edhe në Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoni. Aplikimi i një rrjeti me reputacion si "Accor Hotels", për të hyrë në tregun e Kosovës, është fat i mirë dhe gjithsesi do të kontribuojë për interesimin e kompanive të tjera të këtyre përmasave për fitimin e statusit të investitorëve strategjik në Kosovë.

"Accor Hotels" është një rrjet botëror i hoteleve dhe lider i tregut në Evropë, Amerikën Latine, Lindjen e Mesme, Afrikë dhe Azi. Ky rrjet ka 4 300 hotele në 100 shtete. Në kuadër të këtij grupi veprojnë hotelet më të njohura botërore si "Movenpick", "Fairmont", "Sofitel", "Rixos", "Pullman", "Swissotel", "Grand Mercure", "Novotel", "Ibis" etj.

OEAK-u, MF-ja dhe ATK-ja diskutojnë për çështjet e sektorit të prodhimit

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 31 JANAR - Në mbledhjen e Komitetit të Prodhimit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, me përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Administrata Tatimore e Kosovës, u diskutua rreth çështjeve të cilat e afektojnë këtë sektor, ku fokus i veçantë iu kushtua nevojës për identifikimin e entiteteve prodhuese përmes një numri identifikues.

Kryesuesi i Komitetit të Prodhimit të Odës Amerikane, Kujtim Gjevori, duke vlerësuar reformat e bëra në aspektin fiskal, të cilat kanë mundësuar për rritjen e kompanive prodhuese në Kosovë, ka theksuar domosdoshmërinë e identifikimit të duhur të kompanive që i përkasin këtij sektori në mënyrë që të mundësohet një vlerësim i drejtë dhe i barabartë. Sipas tij, kjo do t'u paraprinte çështjeve të ndryshme me ndikim thelbësor për zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij sektori në të ardhmen si në aspektin e qasjes më të lehtë në financa, po ashtu edhe në luftimin e konkurrencës jolojale.

Lulzim Rafuna nga Ministria e Financave ka thënë se ky institucion është i hapur për propozime dhe rekomandime të cilat kanë për qëllim fuqizimin e sektorit privat në përgjithësi. Ai ka thënë se Ministria e Financave është e fokusuar për hartimin e politikave të cilat janë të orientuara në frymën e biznesit e të cilat nuk paraqesin vështirësi për zhvillimin e sektorit privat.

Andaj, Rafuna konsideroi se një numër i tillë identifikues do të bënte diferencimin e duhur në mes të kompanive prodhuese dhe të tjera, e që rrjedhimisht do të shërbente për rritjen e konkurrencës së drejtë në mes të tjerash. Megjithatë, ai ka shtuar se një gjë e tillë duhet të bëhet përmes përcaktimit të qartë të kritereve identifikuese.

Nahit Sharku nga Administrata Tatimore e Kosovës, po ashtu u pajtua për rëndësinë e pajisjes së entiteteve prodhuese me numër identifikues, pasi konsideron se një gjë e tillë ndikon edhe në adresimin e çështjeve tatimore dhe lehtëson në përgjithësi operimet edhe për Administratën Tatimore. Në këtë drejtim, Sharku ka thënë se mirëpret idenë e Komitetit të Prodhimit të Odës Amerikane për pajisjen me numër identifikues dhe që mbetet në dispozicion për zhvillimin e këtij koncepti. Në fund, palët u pajtuan mbi nevojën për hartimin e një drafti fillestar të modalitetit të zbatimit të kësaj ideje e cila do t'i përfshinte kontributet e aktorëve të rëndësishëm në fushën e prodhimit, në mënyrë që kriteret identifikuese të jenë gjithëpërfshirëse.

Edhe dy kompani kalojnë në Vala

PRISHTINË, 31 JANAR (ER) - Telekomi i Kosovës të enjten ka nënshkruar marrëveshje me Radio Televizionin 21 dhe Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, fikse dhe internetit. "Ne do t'i ofrojmë shërbimet tona Radio Televizionit 21 dhe Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë ku, përveç thellimit të partneritetit mes nesh, do të sigurojmë përvojë të mirë komunikimi me shërbimin e Telekomit të Kosovës", ka thënë Demir Limaj, drejtor i Shitjes në Telekomin e Kosovës. Përfaqësuesit e të dy kompanive u shprehën se komunikimi efektiv është mjet shumë i rëndësishëm për zhvillimin e çdo biznesi në shoqërinë tonë, prandaj kanë zgjedhur Telekomin e Kosovës, pasi shërbimi i ofruar është i shpejtë.

Telekomi i Kosovës ka njoftuar se do të vazhdojë t'u qëndrojë afër konsumatorëve ekzistues, edhe atyre të rinj, duke siguruar bashkëpunim efikas dhe shërbim shumë cilësor.

Nuk ka skenarë të mirë me skenaristë të këqij (2)

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Njeriu i fundit që është i interesuar për zgjedhje të parakohshme është presidenti Hashim Thaçi. Po të ishte interes i tij për të shkuar në zgjedhje, do të ishte harruar kjo temë. Në rast të zgjedhjeve të parakohshme, humbësit më të mëdhenj do të ishin Hashim Thaçi, presidenti aktual i PDK-së dhe PDK-ja, me të cilën askush nuk do të pranonte të bënte koalicion, nëse e vazhdon lojën e taksës. Madje, as AKR-ja, si fuqi dominante politike në Kosovë, nuk do të bashkohej me PDK-në. Për Dardan Gashin nuk jam fort i sigurt, mbase edhe do ta forconte PDK-në. Në jetën e përditshme, qoftë edhe në përpjekje të të bërit politikë, duhet ta ruani një minimum të moralit njerëzor dhe të korrektësisë, nëse doni të bashkëpunoni me dikë. Nëse zgjedhjet do të mbaheshin në 60 ditët e ardhshme, fitues do të dilte, ndonëse nuk e meriton me asgjë, LDK-ja. Për vend të dytë LV-së nuk do të rrezikohej kurse, për vend të tretë do të bënin garë AAK-ja dhe PDK-ja. PSD-ja dhe Nisma, me shumë mund do ta kalonin pragun, kurse AKR-ja do të përfundonte në shportën e mbeturinave joekologjike (të paricikliueshme), sikur edhe Alternativa për Gjakovën!

Koalicionet e mundshme dhe të pamundshme: Koalicioni i paralajmëruar midis LDK-së dhe LV-së, e që, përveç oreksit obez për pushtet, nuk kanë gjë tjetër të përbashkët, edhe mund të ndodhë. Këtij koalicioni do t'i bashkohej, pas divorcit eventual për shkak të tradhtisë bashkëshortore (koalicionit parazgjedhor) edhe AAK-së që, për mendimin tim, do të ketë rritje për 5 %, si dhe Nisma, Alternativa dhe AKR-ja. Me gjasë PDK-ja do ta pësonte fatin e Robinson Krusos, e vetmuar në opozitë, duke pritur dekompozimin politik, thuaja të pashmangshëm. Ky koalicion do të fitonte prej 65-70 deputetë dhe me pakicat ose ndonjë deputet të pavarur do të merrte çdo vendim. Po të ndodhte ky skenar, atëherë edhe Thaçi do t'i bashkohej Robinson Krusos, si i detronizuar dhe pa imunitet! Nuk po e them si do të zhvillohet ky detronizim i Thaçit shkaku se nuk po dihet kur mbahen zgjedhjet. Kështu i shoh gjërat dhe nuk kam asnjë përputhshmëri me parashikimet e Ramush Tahirit!

Ekipi "Shtetëror" Negociator: Herën e parë u takuan me Mogerinin dhe përcjellëset e saj. Herën e dytë u takuan me këshilltarët e Mogerinit. Herën e tretë do të takohen me shoferin e Mogerinit në hyrje të godinës, pa i lënë të futen brenda. Nëse këmbëngulin që të takohen edhe pas kësaj me Mogerinin, mashtruesja nga Brukseli do ta thërrasë policinë belge e cila do t'i deportojë për në Kosovë, sikur të ishin gylenistë! Nuk mbaj kurrfarë përgjegjësie për atë që kam shkruar deri më tani!

Disa arsimtarëve parashkollorë, jo që nuk duhet t'u rriten rrogat, por duhet të penalizohen me heqjen e saj: SBAShK-u, me kamikazin që e ruan veten, por i dëmton të tjerët, kryesisht fëmijë, Rrahman Jasharaj, po kërkon, jo rritje të rrogave, por rritje të vlerës së koeficientit për ta përdorur për shkaqe estetike. Demagog i madh është Rraha. Mirëpo, disa mësuesve dhe mësueseve që ua kanë mësuar shkrimleximin deputetëve të sotëm, jo që nuk duhet rritur rroga, por duhet të penalizohen. E kuptoj se e kanë pasur vështirë t'i mësojnë të shkruajnë sepse alfabeti i gjuhës shqipe ka shumë shkronja dhe një sintaksë të ndërlikuar, mirëpo si nuk i kanë mësuar t'i lexojnë tekstet që ua kanë shkruar të tjerët. Fort turp!

Jam me fat që shkrimet e mia i boton "Epoka e re" dhe jo Koha Ditore përndryshe, për shkak të taksës dhe letrës së Trampit që e konsideroj të rrezikshme dhe të dëmshme për Kosovën, do të ikja për lesh, siç thonë në Tepelenë. Besoj shumë se as presidenti nuk i lexon shkrimet e mia, prandaj ende jam në këmbë dhe jo në listën e Bushit. Për mua nuk paraqet problem taksa 100 %, por marrëveshja e dhimbshme dhe vullneti i shprehur i Hashimit për kompromis me Serbinë! Nuk po e kuptojnë se nuk është me rëndësi a e zbatoni menjëherë një marrëveshje ndërkombëtare, por a e nënshkruani atë, qoftë edhe shumë të dëmshme. Nëse e merrni një detyrim ndërkombëtar, në formë të marrëveshjes së nënshkruar, përralla dhe mashtrim janë votat e 2/3 të deputetëve për t'u ratifikuar apo sovrani përmes referendumit. Nëse kjo legjislaturë nuk e ratifikon, do ta ratifikojë një përbërje tjetër e Kuvendit. Kjo është si puna e kredisë, sa më shumë të mos e paguani detyrimin , përmbaruesin do ta keni te dera!

Nuk besoj në miqësi të përjetshme apo dashuri në politikë. Politika është interes dhe vetëm interes. Nuk e kuptoj si mund ta dojë Kadria më shumë Trampin se Ramushin. Dhe t'u besojë më shumë ndërkombëtarëve se tuajve. Duan të na mashtrojnë. Na duan si të dëgjueshëm dhe të nënshtruar pa asnjë kusht e jo si partnerë. Na duan me brekë të lëshuara. Duan ta marrin Leposaviqin, Zubin Potokun dhe Zveçanin. Duan që Gazivodën ta fusin në një administrim ndërkombëtar për ta ulur mllefin dhe revoltën sikur që edhe Trepçën ta lënë në pat pozicion. Duan që veriun ta spastrojnë nga shqiptarët, që disa fshatra të Luginës t'i bashkojnë me Kosovën pas të cilave nuk do të kishte më shqiptarë në Kosovë. Duan që bashkësinë e komunave serbe, me kryeqytet Mitrovicën e Veriut, ta veshin me kompetenca ekzekutive sikur edhe që pronat dhe statusin e kishës ortodokse ta bëjnë kategori kushtetuese në Kosovë. Duan ta spastrojnë Serbinë nga shqiptarët, kurse pjesën e madhe të serbëve të Kosovës ta lënë në Kosovë që, faktikisht, edhe është dhe ta lënë një element të përhershëm destabilizues të Serbisë në Kosovë të cilët do të mbrohen nga Kushtetuta e Kosovës dhe do të paguheshin nga buxheti i Kosovës.

Me Marrëveshjen e Prespës që u përkrah nga politikanët e kriminalizuar dhe të korruptuar shqiptarë në Maqedoninë e Veriut, shtetësia e Maqedonisë së Veriut u betonua, me armaturë të NATO-s, kurse shqiptarët përfundimisht e humbën rastin të bëhen popull shtetformues në këtë shtet. Plus, me këtë vetëvrasje politike të politikanëve të kriminalizuar dhe të korruptuar shqiptarë në Maqedoni të Veriut, pasi u neutralizuan Lugina dhe shqiptarët në Mal të Zi, Kosova do të trajtohej si rast i izoluar siç edhe donin ndërkombëtarët, pa pasur mundësi të prodhimit të efektit domino në shtetet ku jetojnë shqiptarët. Në këtë rast, Kosova po hynë në krizë të madhe, burgjet do të mbushen plot. Madje më shumë se në Jugosllavinë e Titos dhe të Millosheviqit! **(Fund)**

Jeton Ujkani shkarkohet nga pozita e kryesuesit të Kuvendit të Mitrovicës

MITROVICË, 31 JANAR (ER) - Nën drejtimin e kryesuesit, Jeton Ujkani, e në prani të kryetarit të komunës, Agim Bahtiri, nënkryetarit Faruk Mujka dhe këshilltarëve të kuvendit të komunës, është mbajtur mbledhja e pesëmbëdhjetë e rregullt e Kuvendit të Komunës. Në këtë seancë të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, kryetari Bahtiri ka propozuar shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Kur është propozuar shkarkimi i kryesuesit, Jeton Ujkani, PDK-ja dhe AAK-ja e kanë lëshuar mbledhjen, ndërsa kryesuesi Ujkani e ka ndërprerë seancën. Më pas kryetari Bahtiri ka thirrur mbledhje urgjente pas një ore, ku si pikë e vetme e rendit të ditës u caktua shkarkimi i kryesuesit të Kuvendit Komunal.

Në seancën urgjente, nën udhëheqje të asamblistit më të vjetër, Kujtim Prekazi, me mbështetjen e grupit të këshilltarëve të LDK-së si dhe me votat e gjithsej 19 asamblistëve sa ishin të pranishëm në këtë mbledhje, u shkarkua kryesuesi i kuvendit, Jeton Ujkani.

Defaktorizimi i Kosovës shqiptare, interes vetëm i Serbisë (3)

Rinisja e negociatave me Serbinë për Kosovën në Bruksel

Xhevat BISLIMI

Politikat dhe projektet antishqiptare u shtuan me hapjen ose rinisjen e negociatave me Serbinë në Bruksel për Kosovën! Ky ishte lajm i keq për pozitën ndërkombëtare të shtetit të Kosovës dhe për sovranitetin e saj të kushtëzuar! Për fat, në kohën e defaktorizimit të Republikës së Kosovës erdhi edhe një lajm i mirë: Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë i dha plotësisht të drejtë Kosovës që kishte shpallur pavarësinë e saj... Kjo ishte ngjarje e dorës së parë që legjitimoi dhe vulosi shpalljen e Pavarësisë. Ky opinion, ose mendim i Gjykatës, që ishte përgjigje në pyetjen e Serbisë, e përmirësoi pozitën ndërkombëtare të Republikës së Kosovës dhe e vulosi Pavarësinë. "Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, tha GJND-ja, është plotësisht në përputhje me Rezolutën 1244, me Kornizën Kushtetuese dhe me të drejtën ndërkombëtare". Me këtë opinion edhe Rezoluta 1244 u deklarua e vdekur..."Opinioni i GJND-së i dha fund betejës ligjore të Serbisë dhe pretendimeve serbe duke e bërë të qartë për të gjithë botën", siç do të shprehej ministri i Jashtëm i asaj kohe i Francës, Bernard Kushner, se "tani është e qartë për të gjithë botën se pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme, pavarësisht se si ndihet njëra palë apo tjetra". Apo ashtu si do ta përcaktonte sekretaresh e Shtetit, Hillary Clinton, se: "GjND-ja vendosi për pavarësinë e Kosovës, e cila e vizitoi Prishtinën në vjeshtë si provë e përkushtimit amerikan në Ballkan e Kosovë", shkruante Elida Buçpapaj, më 31 dhjetor 2010, në VOAL (Zëri i Shqiptarëve).

Mirëpo, si për inat të këtij OPINIONI të GjND-së, krerët e Republikës së Kosovës e ringjallën Rezolutën 1244 dhe e bën Republikën e Kosovës me "FUSNOTË"! Kësaj radhe goditja iu dha shtetit të Kosovës mu në zemër nga drejtuesit e saj! Bota mbeti gojëhapur nga ky "gjenerozitet" dhe lojalitet i klasës politike të Prishtinës ndaj Serbisë, që kishte kryer krime monstruoze, kishte bërë gjenocid e holokaust në Kosovën shqiptare! Akoma nuk ishte tharë mirë gjaku i viktimave të Serbisë, era shkrumb i vinte ende Kosovës! Por, krerët e "krisur" nuk ndaleshin! Revani i tyre ishte i papërmbajtshëm!

Të gjendur me "shpatën" e raportit të Dik Martit (BE-së) mbi kokë (pjesa "patriotike" e politikës) dhe duke qenë me hipotekën e kolaboracionistit të djeshëm në shpinë (pjesa e vjetër jugotitiste e politikës) politikanët dhe krerët e shtetit të Kosovës vazhduan ta degradonin Pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës me marrëveshjet që nënshkruanin në Bruksel! Marrëveshja e parë u nënshkrua nga Hashim Thaçi, kurse marrëveshja e dytë nga Isa Mustafa! Ndërhyrja e padukshme e ndonjë miku të fortë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës e rrëzoi marrëveshjen që ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës dhe me vetë sovranitetin dhe pavarësinë e saj! Megjithatë, Serbia dhe miqtë e saj këmbëngulin që marrëveshja të zbatohet siç është nënshkruar në Bruksel... Me këto marrëveshje të nënshkruara nga krerët e Republikës së Kosovës, Serbisë i hapej rruga për krijimin e një "Serbie të vogël", një minishteti serb në Republikën Shqiptare të Kosovës! Parakushtet për një entitet të tillë serb tashmë ekzistonin! Ishin krijuar dhjetë komuna "serbe" e dhjetëra zona të mbrojtura "serbe" në Kosovë! Këtyre komunave e zonave u ishte lënë në administrim (me kufij kadastralë e administrativë) rreth 30 % e territorit të Republikës së Kosovës! Një çmenduri, do të thoshte dikush. Më shumë se kaq: një tradhti e madhe, thotë ndokush sot, e më shumë do të thonë nesër. Ata që kishin hapur këtë hulli nuk po ndaleshin me kaq! Mbase nuk i linin "padronët" të ndaleshin!

I njëjti brumë e i njëjti grup politikanësh e qeveritarësh pranuan si pa të keq krijimin e Gjykatës Speciale për dënimin e luftës së UÇK-së dhe të kombit shqiptar me "votën e lirë" të Kuvendit të Republikës! Arsyetimi për ta themeluar këtë gjykatë, sa raciste aq antihistorike, ishte sa absurd aq idiotesk: "Më mirë ta bëjmë ne sesa të bëhet nga Këshilli i Sigurimit, ku është edhe Rusia", thoshte kryeprotagonisti i themelimit të kësaj Gjykate! Për ta votuar Gjykatën Speciale antishqiptare u shantazhuan e dhunuan burra e gra deputetë! U dhunua Kuvendi i Republikës! U dhunuan krenaria dhe ndërgjegjja e një kombi që luftoi për lirinë e tij! O tempora, o mores!

Presion, shantazh e dhunë e paparë u ushtrua edhe për ratifikimin e marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi, me të cilën Kosovës i shkëputeshin 8 200 hektarë tokë! E njëjta klasë politike, e njëjta logjikë, i njëjti rezultat! Kjo qeverisje arbitrare e autoritare dhe kjo qeverisje e korruptuar dhe kriminalizuar, që kishte e vazhdon ta ketë mbështetjen e qarqeve e qeverive jo fort miqësore për Republikën e Kosovës, prodhoi zhgënjim e dëshpërim masiv... Shumica e të rinjve dhe e popullatës shqiptare kërkon rrugë e shtigje për të ikur nga shtëpitë dhe vendlindjet e tyre! Nuk ka statistika të sakta, sepse këtyre qeverive e tarafeve nuk u interesojnë statistikat për shqiptarët e shpërngulur (!), por mund të them pa frikë se po ekzagjeroj, që gjysma e popullatës shqiptare është shpërngulur tashmë për këto gati njëzetë vjet lirie e 11 vjet pavarësie! Më shumë të shpërngulur shqiptarë pas luftës se para saj! Kurse këta vazhdojnë të qeverisin e shkarravitin këtë vend pa mos iu skuqur faqja!...

Vetëkënaqësia me transformimin e FSK-së dhe me taksën 100 %

Miratimi i ligjeve për transformimin e Forcës së Sigurisë dhe vendosja e taksës 100 % për mallrat e Serbisë dhe të Bosnje-Hercegovinës po përjetohen si (vetë)përmbushje e vetëkënaqësi e një shkalle të lartë dhe po shiten si të arriturat më të mëdha të viteve të Pavarësisë... Këto dy veprime të institucioneve të dominuara e më shumë të kapura nga grupi i "patriotëve" (të mbështetura nga LDK-ja) janë kryesisht rezultat i dështimeve të qeverisjes së këtij grupi brenda e jashtë sesa rezultat i një logjike dhe politike konsekuente shtetërore! Me këtë koalicion qeverisës, njësoj si edhe me qeverisjet e mëparshme, defaktorizimi i Republikës së Kosovës vazhdoi dhe u thellua deri në atë shkallë sa s'mbante më! Shteti i Kosovës ishte buzë falimentimit! Fushata e Serbisë dhe aleatëve të saj, ndërhyrjet dhe prania në rritje e Serbisë në Kosovë, po e shkërmoqnin sistemin dhe shtetin... Tërheqja e njohjeve, dështimi i pranimit në Interpol dhe në UNESCO, etj., nga njëra anë, dhe lidhja e Serbisë këmbë e krye me Rusinë, në anën tjetër, sikur e "kthjellën" klasën politike që po sundon Kosovën me arbitraritet e autoritarizëm! Edhe miqtë tanë të mëdhenj (dikush thotë të përhershëm e të përjetshëm!) u bindën se Serbia nuk mund të ndahet-shkëputet nga Rusia! Bënë mjaft përpjekje e investime për ta joshur Serbinë, por të gjitha shkuan huq! Janë edhe këta faktorë që shpjegojnë "dritën e gjelbër" që mori Kosova për transformimin e FSK-së dhe për vendosjen e taksës...

Këto masa e veprime të Qeverisë së Kosovës patën mbështetjen e të gjitha partive kuvendare dhe të një populli mbarë. Çështja është se a janë të mjaftueshme këto masa e veprime ad-hoc të qeverisë për të siguruar e garantuar pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës? Jo, nuk janë të mjaftueshme. Për të dëshmuar se jemi shtet i pavarur dhe sovran do të duhej të ndërmerreshin edhe një varg masash të tjera kundrejt Serbisë. Taksa është shumë e vonuar. I vonuar është edhe transformimi i FSK-së ose themelimi i forcave të armatosura. Se jemi vonuar po e thotë edhe njeriu më përgjegjës (fajtor) për këtë vonesë! Le që jemi vonuar, por ka shenja se po vonohemi përsëri! "Dhjetë vjet, thonë qeveritarët, na duhen për përmbylljen e transformimit, krijimin e ushtrisë së Kosovës" në kohën që Serbia kishte gjithë atë armatim të paprekur dhe po shpenzon milionat edhe sot për armatim! Shumat e parave që po ndahen për FSK-në janë qesharake! Ato para nuk do të mjaftonin as për kulturë e lëre më për mbrojtjen e vendit...

Vendoset taksa 100 %, kurse jo më larg se 2 km nga Prishtina, në Graçanicë, edhe sot funksionojnë e veprojnë organet e administratës serbe, të organizuara dhe të varura nga Serbia! Dhe jo vetëm në Graçanicën tonë, por edhe në qendra të tjera të Republikës së Kosovës!

Politikat ekonomike (nëse ka politika ekonomike!) të Qeverisë bëhen dhe zbatohen me logjikën e hajdutëve të pyjeve... Ata i presin pyjet e Kosovës e pastaj, për të humbur gjurmë, i djegin! Ndërsa Qeveria së pari i vjedhë e i rrënon ndërmarrjet publike e pastaj i nxjerr në pazar: kush sa jep! Vendimi i fundit me këtë logjikë është ai për privatizimin/shitjen e PTT-së, të cilën e kanë zhvatur, plaçkitur e mbytur në borxhe! Tash duhet falur edhe këtë pasuri kapitale të Kosovës! Këtë fat pati edhe rrjeti i shpërndarjes i KEK-ut! Ishte një prej kontratave më kriminale. Këtë fat pati edhe "Trepça" dhe gjithë ekonomia e pasuria e Kosovës shqiptare!

Mos e fajësoni Amerikën për dështimet tuaja!

ShBA-ja në Kosovë është bërë referencë për mirë e për keq! Të gjitha të arriturat dhe fitoret e popullit shqiptar në Kosovë i faturohen "mikes së përjetshme", Amerikës... Njësoj edhe për të gjitha politikat, qëndrimet, projektet, marrëveshjet dhe vendimet e dëmshme politikanët e Kosovës fshihen pas Amerikës, duke aluduar e duke deklaruar hapur se "kështu e ashtu kërkonte, porosiste a rekomandonte Amerika mike"! Fshehja pas Amerikës për të gjitha dështimet nuk është e ndershme... E ku ta gjejnë ndershmërinë këta politikanë?! Këtë po e bënë kjo klasë politike për ta ruajtur "simpatinë" dhe përkrahjen e elektoratit e për t'i ruajtur pozitat, pasuritë dhe privilegjet e fituara në rrugë e me mënyra të paligjshme!

Amerika e ka ndihmuar luftën e UÇK-së dhe të kombit shqiptar në çaste të vështira, por jo të pashpresë. E kemi thënë më lart se ndërhyrja e NATO-s, me insistimin e Amerikës, ishte bërë edhe për ta "kornizuar" luftën çlirimtare të kombit shqiptar dhe çështjen shqiptare... Sidoqoftë, kombi shqiptar i është mirënjohës Amerikës dhe përkrahjes së saj. Këtu nuk ka dilema. Por, pa sakrificën shqiptare as NATO-ja s'do të ndërhynte... "Nuk mund të kërkojmë, shkruante kryetari Alfred Moisiu, që djelmoshat e Amerikës dhe të Evropës të sakrifikojnë pa qenë të gatshëm ne, të parët, të sakrifikojmë për të drejtat tona". Krahina autonome e Kosovës, e pushtuar nga Serbia, u çlirua tërësisht. Kjo ishte fitore e plotë për Kosovën me kufijtë që kishte imponuar Beogradi. Është përgjegjëse/fajtore klasa politike shqiptare (pa përjashtuar praninë ndërkombëtare) që nuk e kapitalizoi në dy-tri vjetët e para (vitet më të mira) shkëputjen e plotë nga Serbia dhe shpalljen e Pavarësisë! Për fajin kryekëput të kësaj klase politike (qëndrimi i UNMIK-ut dhe disa vendeve nuk duhet të na habiste...) Kosova nuk u shkëput nga Serbia menjëherë pas luftës, nuk u bashkua me shtetin e saj AMË dhe as nuk u shpall shtet i pavarur (me kushtëzime!) deri në vitin 2008!

Kjo klasë politike nuk dëshmoi pjekurinë që priste populli shqiptar! Ajo ra në provimin e historisë! U përfshin nga dalldia e fitores, nga lakmia për para e për pushtet! "Vullnetet e ndërgjegjes së re, do të thoshte Jakov Milaj në librin e tij, 'Raca shqiptare', që ishin të domosdoshme për t'i dhënë jetë një shteti të pavarur jo vetëm politikisht, por edhe shpirtërisht, nuk u krijuan dot". Amerika dhe miqtë tanë prisnin më shumë nga Kosova dhe klasa e saj politike... Amerikës nuk i pëlqenin "allishverishet" e kësaj klase politike me UNMIK-un dhe me Serbinë. Kur politikanët dhe qeveritarët e Kosovës menduan ta krijonin një Kuvend me dy dhoma (një dhomë për pakicat, sidomos atë serbe!) ndërhyri Amerika dhe nuk lejoi. Ndërhyrja e Amerikës ishte pa diplomaci (u detyrua nga pazaret që bënte kjo klasë politike në Bruksel) dhe e drejtpërdrejtë edhe kur u bë marrëveshja për drejtësinë në Bruksel: "Kujdes, tha Amerika publikisht, se po krijoni një republikë serbe"! Si mund ta thotë një shtet, - fuqia më e madhe botërore, - ndryshe? Më qartë e më hapur se kaq s'bëhet e s'thuhet. Amerikën e "fajësonin" edhe për marrëveshjet në Bruksel! Amerika u "fajësua" edhe për marrëveshjen e kufirit me Malin e Zi! Amerikën po e "fajësojnë" edhe për taksën 100 %! Ata që po kërkojnë t'i hiqet taksa Serbisë po fshihen pas "kërkesës" amerikane për heqjen e kësaj takse! Jo zotërinj qeveritarë! Po t'i bënit detyrat e shtëpisë siç duhej e siç ia kërkonte interesi edhe Amerikës, Kosova tash do të festonte 15 a 16-vjetorin e pavarësisë dhe sot do të ishte në pozitë shumë më të mirë ndërkombëtare, por edhe e konsoliduar mirë përbrenda: pa komunat e zonat e mbrojtura "serbe", pa Veriun e ndarë, pa këtë korrupsion e kriminalitet, me ekonomi dhe stabilitet solid... Mirëpo, ju zotërinj kishit "objektiva" dhe interesa të ndryshme nga ato të Kosovës! Prandaj, është koha t'i thirrni mendjes e të ktheheni në shtratin e interesave të Kosovës dhe të kombit shqiptar, nëse nuk është bërë vonë, ose të tërhiqeni e ta lini të qetë Kosovën dhe popullin e saj shqiptar! Kjo e dyta do të ishte më e mira për ju dhe për Kosovën shqiptare. Defaktorizimi i mëtejmë i Kosovës është interes vetëm i Serbisë...

(Fund)

Traktati i armëve bërthamore tensionon Moskën dhe Uashingtonin

MOSKË, 31 JANAR - Të enjten zëvendësministri i Jashtëm i Rusisë tha se nuk janë arritur të kapërcehen dallimet e Moskës me Uashingtonin mbi një traktat të rëndësishëm të armëve të periudhës së Luftës së Ftohtë. Deklarata e tij u bë publike nga agjencitë ruse të lajmeve. Bisedimet e fundit të zhvilluara në Pekin nuk arritën t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet mbi këtë çështje.

Shtetet e Bashkuara thonë se sistemi rus nuk është në përputhje me Traktatin e Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme Veprimi, pasi aftësia e tyre i tejkalon kufijtë e paracaktuar nga marrëveshja.

ShBA-ja akuzon Rusinë për destabilizim të sigurisë globale, duke refuzuar t'i shkatërrojë raketat që Uashingtoni këmbëngul se bien në kundërshtim me marrëveshjen.

Si përgjigje ndaj situatës pa rrugëdalje, një zyrtar i lartë amerikan tha të enjten për agjencinë "Reuters" se Qeveria amerikane ka të ngjarë ta nisë tërheqjen nga traktati i vitit 1987 në ditët e ardhshme.

Moska i mbahet qëndrimit se Uashingtoni i ka shpikur shkeljet, në mënyrë që të dalë nga marrëveshja, diçka që do t'u jepte mundësi Shteteve të Bashkuara të prodhonin raketa të reja.

Populistët evropianë përgatiten për zgjedhjet e majit

Bashkimi Evropian po përgatitet për zgjedhje në maj dhe ka rrezik që balanca e forcave të zhvendoset dukshëm, që tregon se Lëvizja populiste mishëron një numër kontradiktash dhe po ndeshet me konkurrencë në rritje

BRUKSEL, 31 JANAR - Nga Suedia në jug të Spanjës, nga Holanda në Hungari, forcat populiste kanë dërguar deputetë në parlamente pas fitoreve në zgjedhje. Bashkimi Evropian po përgatitet për zgjedhje në maj dhe ka rrezik që balanca e forcave të zhvendoset dukshëm. Lëvizja populiste mishëron një numër kontradiktash dhe po ndeshet me konkurrencë në rritje.

Jelekët e verdhë vazhdojnë për të njëmbëdhjetën javë protestat në Francë. Në mes të kësaj atmosfere të ndezur po bëhen edhe përgatitjet për zgjedhjet e majit për Parlamentin evropian.

Forcat populiste, të mbështetura nga energjia e protestave, duken të përgatitura për t'i bërë zgjedhjet e ardhshme të paharrueshme në historinë e bllokut, thotë analisti Michael Cottakis. "Tani është mundësia për ta shfrytëzuar rastin dhe për t'i siguruar ato politika që kërkon. Po shohim kulmin e një lëvizjeje populiste të vonuar, në përgjigje të një periudhe të gjatë vështirësish ekonomike", tha ai.

Udhëheqësja e ekstremit të djathtë në Francë, Marine Le Pen, po përpiqet ta bashkojë lëvizjen e saj me protestuesit me jelekë të verdhë. "E ka kuptuar se nuk jemi të ligj, se kishim dalë në protesta pasi kishim mbetur pa bukë. Jemi të uritur, kemi ftohtë, kemi nevojë për para por, për fat të keq, paratë u jepen të huajve", thotë një protestuese.

Në mbarë Evropën populistët po përpiqen për një goditje të bashkërenduar në zgjedhjet e majit. Ja si shprehet lidhur me protestat në Francë ministri i Brendshëm italian, i cili i përket ekstremit të djathtë. "Shpresoj që francezët të arrijnë të çlirohen nga një president shumë i keq. Do ta kenë mundësinë më 26 maj", tha ai.

Ministri Salvini po përpiqet të formojë aleanca me qeverinë në Hungari dhe atë në Poloni. Të gjithë kanë identifikuar si armik të përbashkët imigracionin. Por ka një numër kontradiktash. "Italia kërkon nga vendet e tjera që të pranojnë refugjatë. Hungaria e ka thënë prerazi se nuk do të pranojë", thotë analisti Luigi Scazzieri.

Populistët evropianë janë të përçarë në një numër temash. "Italia është anëtare e Eurozonës, por jo Polonia. Në politikën e jashtme, Polonia beson me forcë te vlera e NATO-s, pasi tmerrohet nga Rusia dhe nuk i zë besë Putinit, ndërsa Salvini e ka mbështetur haptazi", thotë analisti Michael Cottakis.

Po marrin trajta kampet kundërshtare. Në Paris qindra protestues, me shalle të kuqe zhvilluan demonstrata, duke iu kundërvënë jelekëve të verdhë me mesazhe pro BE-së.

Në Hungari demonstratat antiqeveritare kanë ardhur duke u rritur.

Në Gjermani, Partia e Gjelbër e ka kapur në anketa Alternativën për Gjermaninë që përfaqëson ekstremin e djathtë.

Populistët po zbulojnë se nuk janë të vetmit në protesta, por prova e vërtetë do të zhvillohet më 26 maj në kutitë e votimit, kur rezultati i zgjedhjeve mund ta zhvendosë balancën e forcave në Evropë.

PE-ja e njeh Guaidon si president të përkohshëm të Venezuelës

STRASBURG, 31 JANAR - Parlamenti Evropian e njohu presidentin e vetëshpallur të Venezuelës, Juan Guaido, si udhëheqës de facto të këtij shteti, duke rritur kështu presionin ndërkombëtar mbi presidentin socialist të Venezuelës, Nicolas Maduro.

Ligjvënësit e BE-së votuan me 429 vota për, 104 kundër dhe 88 abstenime në një sesion të posaçëm në Bruksel.

Ndonëse votimi nuk është i obligueshëm, Parlamenti Evropian, përmes një deklarate, kërkoi nga 28 qeveritë e BE-së ta konsiderojnë Guaidon "të vetmin president të përkohshëm legjitim" derisa të ketë zgjedhje të reja presidenciale në Venezuelë, të lira, transparente dhe të besueshme.

Guaido është vetëshpallur president javën e kaluar, pas protestave masive kundër Maduros. Ai ka nisur këtë muaj mandatin e dytë gjashtëvjeçar, por zgjedhjet, që janë mbajtur vitin e kaluar, janë konsideruar gjerësisht si jolegjitime.

Nën udhëheqjen e Maduros, ekonomia e Venezuelës ka rënë ndjeshëm, duke çuar në inflacion të lartë, mungesa ushqimesh dhe ndërprerje të rrymës. Maduro këmbëngul se nuk do të largohet nga pushteti dhe ai e ka mbështetjen e ushtrisë. ShBA-ja, Kanadaja, shumica e vendeve në Amerikën Latine dhe të tjera e kanë njohur Guaidon si president të përkohshëm. Rusia, Turqia, Siria janë në mesin e vendeve që janë radhitur përkrah Maduros.

Mësuesi Jetish, flakadan i Karadakut që s'shuhet kurrë...

Duke kujtuar veprimtarinë, përkushtimin, sakrificën dhe idealizmat më të fisme të Jetish Bislim-Vishit, mbase është koha që Republika e Kosovës dhe shqiptarët në përgjithësi ta nderojnë këtë figurë të rrallë atdhetare

Shkruan: Faton BISLIMI

Gjatë përpjekjeve për ta mbajtur vetëqenien, lirinë dhe dinjitetin e tij, populli ynë ka nxjerrë nga gjiri i vet njerëz të shquar të penës dhe pushkës që mbajtën gjallë drejtpeshimin e mbijetesës. Ata me përpjekje titanike kanë mbajtur gjallë flakën dhe idealizmin ndër bashkëkombës - dashurinë për atdheun dhe gjuhën amtare.

Një ndër ta është edhe Jetish Bislimi-Vishi nga Vërbani i Vitisë (Anamoravë).

I lindur dhe rritur në një familje bujare dhe atdhetare, Jetish Vishi gjatë tërë jetës së vet ndau fatin e popullit të vet të shumëvuajtur nën zgjedhën e regjimit pushtues serb, por pa u nënshtruar asnjëherë. Herët e shqetësoi ëndrra për liri të Kosovës dhe si njeri i mendjes dhe shpirtit të vendosur që përmes arsimimit dhe zhvillimit kulturor të bashkëkombëseve të hiqnin qafe zgjedhjen e huaj.

Dëshira e madhe për dituri, e bëri atë të ndiqte njërën pas tjetrës shkollat fetare të kohës, kryesisht në Shkup, siç është shkolla "Isa Beu", të cilën e kreu me sukses si dhe shkollën e mësuesisë. I ndikuar dhe motivuar nga qëndresa e popullit shqiptar kundër shtypjes së huaj, nuk qëndroi duarkryq, por filloi dhe veproi pa u ndalur në sendërtimin e ëndrrës për liri. Kjo veprimtari në interes të arsimimit dhe ngritjes së shqiptarëve u ra shpejt në sy hienave pushtuese dhe shpejt do ta prangosin, por pa arritur ta ndalojnë nga përkushtimi i kësaj kauze.

Ndjekjet e vazhdueshme nga pushteti sllavo-komunist jugosllav do ta detyrojnë atdhetarin Jetish Bislim-Vishi të shtegtojë nga fshati në fshat si një misionar i mësuesisë duke u fshehur më së shumti në fshatrat malore të Malësisë së Shkupit, ku edhe kishte hapur shkollat e para shqipe.

Jeta në mesin e malësorëve i dha më shumë mundësi ta njihte shpirtin e përvuajtur dhe hallet e shumta të shqiptarëve, por edhe krenarinë dhe dinjitetin e tyre të papërkulur, shqetësime dhe vlera këto që aq bukur i regjistroi për dekada.

Në fletëzat e kësaj biografie i bëri jehonë kryengritjes së Karadakut udhëhequr nga i vëllai i tij, me gradën kapiten, Bajram Bislimi-Vishi, i cili pamundësoi që hordhitë serbo-komuniste ta shkelnin Malësinë e Shkupit.

Jetish Bislmi-Vishi me përkushtim e sakrifica si mësues i pashembullt nuk u ndal së përhapuri rrezet e dritës në fushën e arsimit dhe edukimit që populli i tij sa më shpejt të hapëronte drejt një civilizimi evropian, sepse prapambetja dhe moszhvillimi, si pasojë e pushtimeve të egra, kishte lënë shumë prapa në krahasim me popujt e tjerë në këtë pjesë të Ballkanit.

I frymëzuar nga idealizma dhe personalitetet e ndritshme kulturore dhe atdhetare të Rilindjes Kombëtare Shqiptare bëri që Jetish Bislimi-Vishi të mos kursente jo vetëm energjitë pozitive dhe shëndetin, por edhe krejt pasurinë ta shkrinte në realizmin e kësaj ëndrre për një të ardhme më të mirë.

Kështu që në vitin e largët 1942 e gjejmë në Ministrinë e Arsimit në Tiranë në pritje të Ernest Koliqit, i cili nënshkruan dekretin, duke e angazhuar me mision mësuesie në Anamoravë. Ndërkaq, edhe hapi shkollën e parë shqipe në Vërban të Vitisë, zonë kjo nën pushtimin dhe administrimin e italianëve.

Ernest koliqi ishte shprehur i mahnitur me njohuritë dhe personalitetin intelektual dhe atdhetar të Jetish Bislimit-Vishit. Njohjet e tij të thella të historisë kombëtare, posaçërisht aftësinë e tij, që vargjet e poetit kombëtar të Gjergj Fishtës dhe plejadës së tij i dinte krejt përmendësh.

Ernest Koliqi do ta ndihmonte me krejt ç'pati mundësi këtë mësues dhe e nisi për Udhën e Shkronjave në Kosovë. Mësuesi me të arritur në Vërban, në qendër të fshatit vendosi ta valonte flamurin kuq e zi dhe portretin e Skënderbeut, duke u dhënë zemër qëndrese krejt shqiptarëve të kësaj ane. Kjo kohë edhe sot kujtohet me nostalgji dhe admirim nga bashkëfshatarët e tij, që ende janë në jetë: Ajet Vishi, Rrahim Vishi dhe të tjerë, të cilët shpejt lanë mënjanë mësimet në mejtepin e fshatit për t'u ulur pastaj në bankat e shkollës së re në Vërban, përballë mësuesit Jetish, apo nën dritën e flakadanit të Karadakut.

Jetish Vishi, pos punës si mësues në Vërban, jetësisht u angazhua edhe për ngritjen e vetëdijes kombëtare ndër fshatrat e rrethit të Anamoravës, i vetëdijshëm se interesat dhe rreziqet e atdheut ndodheshin në udhëkryq, prandaj mobilizimi dhe vetëdijesimi sa më masiv i popullit duhet të jetë parësor.

Kërcënimet ndaj atdheut të shqiptarëve vinin si nga jashtë ashtu edhe nga brenda.

Jetish Bislimi do të veprojë si mësues e atdhetar edhe në rrethinat e Tetovës. Në Zhelinë e Reçicë, pos hapjes së shkollave, shtrinë edhe aktivitetin e NDSh-së, për çka fiton zemrat, simpatinë dhe besimin e shqiptarëve liridashës të kësaj ane. Ai nuk prante në përhapjen e ideve iluministe dhe atdhetare kudo që ndodhej në kontakt me popullin, qoftë në oda, xhami apo në rrugë.

Kjo veprimtari e mësuesit nga Vërbani i Vitisë u etua shpejt (1948) nga OZNA dhe UDB-a. Mori dhjetë vjet burg të rëndë, por shtatë të mbajtur nëpër kazamatet famëkeqe jugosllave. Pavarësisht prej kësaj sakrifice, Jetish Bislimi luftën për Shqipëri etnike nuk e ndali asnjëherë. Pas largimit të detyrueshëm nga vendlindja, vendoset në Obiliq (Kastriot), ku punon me përkushtim si mësues, duke e ndërruar mbiemrin nga Bislimi në Vishi. Ai mbi të gjitha kishte ndikuar në rrethin e vet familjar që të arsimoheshin e të shkolloheshin profesione të ndryshme. Falë mësuesit Jetish, Bislimat e Vërbanit janë mbi 150 me kualifikime superiore shkollore në mesin e tyre: doktorë shkencash në mjekësi, inxhinieri, histori dhe profile të tjera.

Jetish Vishi prapë heton se hienat e shërbimeve sekrete jugosllave po e ndiqnin, prandaj bie në kontakt me bashkëluftëtarin e vjetër të Shqipërisë Etnike, Hysen Tërpezën dhe me iniciativën e tij, përmes Turqisë, shkon në Amerikë për ta hapur shkollën shqipe në Nju Jork.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 dhe krijimin e rrethanave të reja në Kosovë, Jetish Vishi kthehet prapë në Obiliq (1978, i dërrmuar tashmë nga shtegtimet kurbetçare, por me porosi të qarta se pushtuesi "do plumb, e jo bukë").

Jetish Vishi i mbylli sytë pa e parë Kosovën e çliruar, peng i mbeti Shqipëria Etnike, mbi gurët e varrit, sipas porosisë, ka këtë epitaf: "Vdiq me liri në zemër, por pa e shijuar". Është koha që shteti dhe "Shqipëria e tij e ëndërruar" të bëjnë diçka për të nderuar këtë figurë dhe personalitet të rrallë si në Viti, Prishtinë, mbase edhe në Tiranë.

E rrallë

Në ditën e fundit të punës paraqitet i veshur si Spiderman

Jo më xhaketë dhe kravatë. Për 'lamtumirën' e tij të fundit në vendin e punës, dukshëm të padëshiruar, një punonjës ka vendosur të paraqitet ditën e fundit në zyrë, i veshur si Spiderman. Ngjarja ndodhi në San Paolo në Brazil, ku burri është shfaqur mes tavolinave dhe kompjuterëve me kompletin e kuq dhe blu të superheroit Spiderman. Nuk dihet identiteti i këtij nëpunësi të bankës, i kthyer në një 'super hero' për rrjetet sociale që kur fotografitë dhe pamjet e tij nisën të qarkullojnë në internet.

FOTO E DITES

Alpinisti francez Alaine Robert, i njohur si 'Spiderman', ngjitet në ndërtesën 47-katëshe GT Tower, në qytetin Makati në lindje të Manilës në Filipine. /AP/

E jashtëzakonshme

Dhëndri ecën 6 kilometra në dëborë për të marrë pjesë në ceremoninë e dasmës

Një dhëndër ka ecur këmbë të paktën gjashtë kilometra në mes të dëborës për të marrë pjesë në ceremoninë e vet të dasmës. Të paktën 80 njerëz duhej të merrnin pjesë në dasmë, por ata u bllokuan nga dëbora në fshatin Triyuginarayan. Familja e dhëndrit vendosi të dërgonte vetëm disa të ftuar që ishin të nevojshëm për ritualet tradicionale të dasmës, duke përfshirë xhaxhanë e dhëndrit, motrat dhe të afërmit e moshuar, raporton "Hindustan Times".

BARSOLETA E DITËS

Djali:
- Babi, a është e vërtetë se në disa vende burrat nuk i njohin gratë para martese?
Babai:
- Ajo ndodh në gjithë planetin, bir. Pasi martohesh e merr vesh kush është gruaja.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Keni filluar disa ditë pushim për t'i qartësuar idetë. Shumë persona pranë jush janë treguar oportunistë dhe mosmirënjohës.

DEMI
Edhe pse një nga bashkëpunëtorët tuaj nuk është treguar korrekt me ju, përsëri nuk do t'i bini në sy dhe do të vazhdoni çdo gjë si në fillim.

BINJAKËT
Nuk jeni shumë të qartë sot sepse tjetër gjë thoni dhe ndryshe veproni. Keni disa çaste tensioni që do t'ju prishin ditën.

GAFORRJA
Nëse doni të jeni një me skuadrën që po punoni sot, duhet ta lini mënjanë krenarinë tuaj dhe të bashkoheni edhe në oraret e vona.

LUANI
Po lini shumë takime përgjatë ditës sot dhe nuk do të mund t'i përballoni. Çdo gjë do të ndikojë në mbarëvajtjen e ditës dhe humorin tuaj.

VIRGJËRESHA
Nuk keni shumë besim tek personat që ju rrinë pranë dhe kjo ju ka bërë të mbyllur në vetvete. Sot nuk do të jetë një ditë nga më të mirat.

PESHORJA
Sot duhet të jeni këmbëngulës dhe të çoni deri në fund një punë të nisur. Nëse testoni situata të ndryshme do të kuptoni se sa pak ju mbështesin.

AKREPI
Duhet të jeni pak më të shkathët sot që në momentin që ju jepen oportunitetet të dini t'i shfrytëzoni. Nëse veproni siç duhet do të keni përfitime.

SHIGJETARI
Po përtypni brenda vetes një ndjenjë që nuk është aspak e mirë. Keni përshtypjen që janë të tjerët që nuk janë korrektë, por është krejt e kundërta.

BRICJAPI
Nuk mund të refuzoni një ftesë bërë në çastet e fundit sot. Do të shikoni që aty do të jetë ambienti të cilit i përkisni.

UJORI
Duhet të hiqni dorë nga situata dhe persona të njëjtë në jetën tuaj për të filluar një cikël të ri.

PESHQIT
E keni shumë të qartë se çfarë duhet të bëni sot dhe si duhet të silleni me personat që nuk ndajnë të njëjtin mendim me ju.

Brad Pitti thotë se vajza e tij, Vivienne, ngjan me të ëmën

Aktori Brad Pitt është ndarë nga gruaja, aktorja Angelina Jolie. Një burim i afërt ka thënë për "Hollywood Life" se Pitt mendon se vajza e tyre Vivienne ngjanë me të ëmën, Jolien. Sipas këtij burimi, Pitt ka thënë se vajza e tij duket e mrekullueshme si nëna e vet.

Rafael Nadali fejohet me të dashurën pas 14 vjetësh lidhje

Rafael Nadali është e fejuar me të dashurën e vet prej 14 vjetësh, Mery Perello. Çifti do të martohet në vjeshtë në një ceremoni në Mallorka. Raportohet se Rafa i propozoi fejesën Meryt, e njohur ndryshe si Xisca, në maj të vitit të kaluar, gjatë një udhëtimi romantik në Romë, por e mbajtën sekret fejesën për tetë muaj. Tenisti në një intervistë më parë la të nënkuptohej se dëshironte të kishte fëmijë me të dashurën. "Natyrisht se kam për qëllim të krijojë një familje. I dua fëmijët dhe do të dëshiroja që fëmijët e mi të bënin atë që i pëlqen", ka thënë Nadali.

Janet Jacksoni shkëlqen sërish

Këngëtarja Janet Jackson ka pasur një karrierë jashtëzakonisht të suksesshme të këndimit që përfshin një periudhë më shumë se tri dekada. Janet të mërkurën në mbrëmje mori pjesë në 20-vjetorin e "Show The Carnival Choreographers Ball" në Hollywood. Sipas "Daily Mail", këngëtarja dukej ashtu e njëjtë si në vitet '90 dhe nuk është plakur aspak.

Vëllai i Ariana Grandes prish lidhjen treshe të dashurisë

Ariana Grande nuk është personi i vetëm në familjen e saj që thotë: "Faleminderit, vazhdojmë me tjetrin". Frankie, vëllai i këngëtares së talentuar, kohët e fundit zbuloi se ka prishur lidhjen e tij të dashurisë me çiftin e martuar gay që i kishte njohur prej pesë muajsh. Aktori 36-vjeçar konfirmoi se marrëdhënia e tij me Daniel Sinasohnin dhe Mike Pophisin kishte përfunduar. "Jam vetëm. Kam rreth një muaj që jam ndarë", ka thënë ai për mediet amerikane.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE | FENERBAHCE - GOZTEPE 1 | HANNOVER - LEIPZIG 2&3+ | LECCE - ASCOLI 1+

Është bërë kategorizimi i sporteve, sportistëve dhe trajnerëve

"Këtë herë kanë aplikuar 31 federata për kategorizim, kurse prej tyre 29 janë të kategorizua dhe dy kanë mbetur jashtë. Janë gjithsej gjashtë federata që kanë hyrë në Grupin A, 13 federata në Grupin B, kurse 6 federata në Grupin C dhe katër kanë mbetur në Grupin D", ka thënë Shasivar Haxhijaj

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 31 JANAR - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) për të dytin vit me radhë ka bërë kategorizimin e sporteve, sportistëve dhe trajnerëve. KOK-u të enjten publikoi rezultatet e këtij kategorizimi për vitin 2019, duke u bazuar në Rregulloren nr. 04/2018 për Kategorizimin e Sporteve dhe Rregulloren Nr. 05/2018 për Kategorizimin e Sportistëve dhe Trajnerëve, të nxjerra nga Ministria për Kulturë, Rini e Sport.

Kryetari i komisionit për kategorizimin e sporteve, Shasivar Haxhijaj, i cili është sekretar i përgjithshëm i KOK-ut, ka thënë se me rregulloren e re është më i lehtë vlerësimi i kritereve për kategorizim. "Kësaj radhe kanë aplikuar 31 federata në total për kategorizim, kurse prej tyre 29 janë të kategorizua dhe dy kanë mbetur jashtë. Janë gjithsej gjashtë federata që kanë hyrë në Grupin A, 13 në Grupin B, kurse 6 në Grupin C dhe katër kanë mbetur në Grupin D", ka thënë Shasivar Haxhijaj.

Xhudoja, karateja, futbolli, basketbolli, hendbolli dhe volejbolli kanë hyrë në kategorinë A, kurse në kategorinë B, sipas rezultateve të arritura, kanë hyrë atletika, noti, sporti shkollor, skitaria dhe pingpongu. Në kategorinë C janë përfshirë trembëdhjetë federata sportive: tenisi, mundja, boksi, taekwondo, gjimnastika, shahu, shenjëtaria sportive, shigjetaria, bodybuildingu, çiklizmi, peshëngritja, boulingu, aeronautika dhe autosportet. Ndërsa në kategorinë D janë: sporti universitar, kikboksi, bjeshkataria dhe Federata Sportive e Punëtorëve. Federata e Badmintonit dhe e Minigolfit nuk janë kategorizuar. Në kategorizimin e sportistëve, xhudoja prinë me tetë sportiste, kurse karateja është e dyta me pesë sportiste, kurse nga sporti janë atletika dhe boksi. Ndërsa në listën e trajnerëve janë pesë. Komiteti Olimpik ka njoftuar se tash do ta dërgojë rekomandim me rezultate në Ministrinë e Sportit, e cila, bazuar në vlerësimin e pikëve dhe kategorive, do ta caktojë shumën për financim të federatave, sportistëve dhe trajnerëve.

KATEGORIZIMI I SPORTEVE 2019

KATEGORIA A	2019 (pikët)
Federata e Xhudos e Kosovës	86.2 pikë
Federata e Karatesë e Kosovës	86
Federata e Futbollit e Kosovës	81.35
Federata e Basketbollit e Kosovës	72.58
Federata e Hendbollit e Kosovës	72.28
Federata e Volejbollit e Kosovës	71.67
KATEGORIA B	
Federata e Atletikës e Kosovës	63.416 pikë
Federata e Notit e Kosovës	54.086
Federata e Sportit Shkollor e Kosovës	54
Federata e Skitarisë e Kosovës	53.64
Federata e Pingpongut e Kosovës	51.76
KATEGORIA C	
Federata e Tenisit e Kosovës	49.07 pikë
Federata e Mundjes e Kosovës	47.89
Federata e Boksit e Kosovës	46.42
Federata e Taekwondosë e Kosovës	44.26
Federata e Gjimnastikës e Kosovës	43.69
Federata e Shahut e Kosovës	41.65
Federata e Shenjëtarisë Sportive	40.93
Federata e Shigjetarisë e Kosovës	40.865
Federata e Bodybuildingut	38.91
Federata e Çiklizmit e Kosovës	38.2
Federata e Peshëngritjes e Kosovës	36.37
Federata e Boulingut e Kosovës	35.04
Federata e Autosporteve e Kosovës	31.51
Federata e Aeronautikës e Kosovës	30.94
KATEGORIA D	
Federata e Sporteve Universitare e Kosovës	28.57
Federata e Kikboksit e Kosovës	27.21
Federata e Bjeshkatarisë e Kosovës	24.61
Federata e Punëtorëve Sportivë e Kosovës	20.88
KATEGORIZIMI I SPORTISTËVE	
XHUDO	
Majlinda Kelmendi	100 pikë
Nora Gjakova	60 pikë
Distria Krasniqi	50
Loriana Kuka	45
Akil Gjakova	45
Shpat Zeka	25
Erza Muminoviq	20
Laura Fazliu	10
KARATE	
Herolind Nishevci	60 pikë
Adelina Rama	20 pikë
Fortesa Orana	20
Orges Arifi	7.5
Blodin Pakashtica	7.5
ATLETIKË	
Musa Hajdari	15 pikë
BOKS	
Donjeta Sadiku	12.5 pikë
KATEGORIZIMI I TRAJNERËVE	
Driton Kuka (xhudo)	177.50 pikë
Shqipe Zogiani (karate)	50
Nazmi Gashi (karate)	10
Zijadin Kryeziu (atletikë)	7.5
Besim Brahimi (boks)	6.25

Shtatë futbollistë prezantohen te Dukagjini

KLINË, 31 JANAR - KF Dukagjini nga Klina në rrugëtimin drejt inkuadrimit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll ka prezantuar shtatë përforcimet e bëra në këtë afat kalimtar. Bëhet fjalë për portierët: Enis Manxholli (KF Besa) dhe Dardan Podrimaj (KF Istogu). Kjo skuadër nuk u ndal me kaq, sepse prezantoi edhe dy mbrojtësit: Muharrem Musën (KF Drenica) dhe Drin Lladrovci (KF Arbëria). Ndërsa përforcimet për repartet e mesfushës dhe sulmit për skuadrën që synon inkundrimin në elitë janë: Fuat Karabeg (KF Ferizaj), Burim Qorri (KF Vëllaznimi) dhe Ardit Berisha (KS Besa Kavajë).

Berisha në pesëshen e javës të FIBA Europe Cup

PRISHTINË, 31 JANAR - Basketbollisti i KB Prishtina, Dardan Berisha, është përzgjedhur në pesëshen më të mirë të javës në FIBA Europe Cup. Berisha në ndeshjen e zhvilluar në Hungari ndaj Szolnoki Olaj realizoi 31 pikë, tetë asistime dhe katër kërcime dhe dy topa të vjedhur, por në fund kjo ishte e pamjaftueshme për skuadrën e Prishtinës që të mos pësojë humbje. Në pesëshen më të mirë bëjnë pjesë edhe Trae Golden (Avtodor Saratov), Hristo Zahariev (Lukoil Levski), Boris Saviq (Avtodor Saratov), Rashwan Thomas (Dinamo Sassari).

Valdet Rama prezantohet te Kukësi

Kukës, 31 janar - Mesfushori nga Mitrovica, Valdet Rama, karrierën do ta vazhdojë te klubi shqiptar, Kukësi. Rama, që ka luajtur edhe në Bundesligë e La Liga, së fundmi ishte pjesë e skuadrës kineze YB Funde. "Klubi njofton arritjen e marrëveshjes me Valdet Ramën. Mesfushori ka firmosur kontratën me skuadrën tonë deri në përfundim të kampionatit dhe pjesëmarrjen në Kupën e Evropës, me opsion rinovimi edhe për një vit. Futbollisti i lindur në Mitrovicë vjen nga skuadra e YB Funde e Kinës dhe do t'i bashkohet menjëherë ekipit tonë", thuhet në njoftimin e Kukësit. Rama gjatë karrierës së vet ka luajtur për Wolfsburg II, Ingolstadt, Hannover, Hannover, Orebro, Valladolid, 1860 Munich, WUrzburger Kickers dhe Yanbian Funde.

Rashica kujton kohën e luftës dhe suksesin historik në Ligën e Kombeve

Bremen, 31 janar - Ylli i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Milot Rashica, e ka treguar dashurinë e vet për vendlindjen, Kosovën, në një intervistë për faqen zyrtare të klubit të tij, Werder Bremenit. Rashica e kishte filluar karrierën si futbollist në Kosovë dhe për shkak të talentit të tij, arriti ta sigurojë një transferim në Holandë, për Vitessen. Përkundër kësaj arritje, ai e konsideron triumfin e Kosovës në Ligën e Kombeve si arritjen më të madhe të karrierës së tij. "Dy transferimet, një herë nga Kosova në Eredivisie, pastaj në Werder janë momente të veçanta në karrierën time, mirëpo mendoj se triumfi në grupin e Ligës së Kombeve me vendlindjen time është momenti im i preferuar", ka thënë Rashica.

Përkundër që është duke jetuar për pothuajse katër vjet larg Kosovës, në Holandë dhe Gjermani, Rashica ka bërë me dije se ai ende është shumë i lidhur me Kosovën, duke rrëfyer edhe për kohën e luftës. "Unë kam lindur në Kosovë, isha në shkollë atje, luajta atje deri në moshën 18-vjeçare. Jam ende shumë i lidhur me vendim tim. Shumë njerëz vdiqën gjatë luftës dhe humbën shumë anëtarë të familjes, shumë njerëz vuajtën gjatë asaj kohe. Kishte dhe ende ka shumë konflikte. E kaluam

një rrugë të gjatë derisa e fituam këtë liri dhe tani po luaj për vendin tim. Nuk u njohëm nga FIFA si federatë e futbollit për një kohë të gjatë. Për këtë arsye, kjo gjë është shumë e rëndësishme për mua", është shprehur Rashica. Në këtë intervistë, Rashica bëri me dije se ushqimet e tij të preferuara janë ushqimet tradicionale shqiptare, si flija dhe byreku. Ai zbuloi se artisti i tij i preferuar është Unikatili, në mesin e shumë artistëve të tjerë shqiptarë.

Deneveri mposhti New Orleansin

New Orleans, 31 janar - Denver Nuggets siguroi fitoren e katërt radhazi, duke u konfirmuar forcë e dytë në Konferencën e Perëndimit pas Golden State Warriorsit. Në përballjen e radhës Denveri u imponua 99-105 në fushën e New Orelans Pelicansit, që vazhdon ta vuajë mungesën e Anthony Davisit. Nuggetsi e bën diferencën në periodën e tretë me një rezultat të pjesshëm 19-33, në një mbrëmje ku Nikola Jokiq realizoi "triple-double": 20 pikë, 10 asistime dhe 13 "rebounde", raporton "Supersport".

Fitore e pastër 126-94 e Boston Celticsit ndaj Charlotte Hornetsit. Pa Kyrie Irvingun në dispozicion, te të zotët e shtëpisë spikati Terry Rozier me 17 pikë e 10 "rebounde", e sidomos Jaylen Brown me 24 pikë e 10 topa poshtë

koshit. Dëmtimi i Victor Oladipos ka shënjuar sezonin e Indiana Pacersit, që e ka të vështirë të ringrihet pas humbjes së "yllit" të tyre. Vjen disfata e tretë radhazi 107-89 në parketin e Washington Wizardsit, ku shkëlqyen Bradley Beal dhe Jeff Green, me 25, respektivisht 23 pikë. Një kosh i pabesueshëm në sekondën e fundit nga Karl Anthony Towns (16 pikë dhe 10 "rebounde") i dha fitoren 99-97 Minnesota Timberwolvesit ndaj Memphis Grizzliesit. Një magji e vërtetë nga qendra e T'Wolves, që duhet të falënderojë edhe Jerryd Baylessin për 19 pikët dhe 12 rikuperimet e tij, ndërsa Memphisit nuk i mjaftuan 26 pikët e Mike Conleyt. Nuk ka fund kriza e New Youk Nicksit, që u mposht në "Madison Square Garden" nga Dallas Mavericksi 90-114, ndërsa në suksesin e thellë 132-105 të Portland Trail Blazersit ndaj Sacramento Kingsit ishte i papërmbajtshëm Damian Lillard me 36 pikë e 11 "rebounde".

REZULTATET

Boston Celtics - Charlotte Hornets	126-94
Miami Heat - Chicago Bulls	89-105
New York Knicks - Dallas M.	90-114
Minnesota T. - Memphis G.	99-97
New Orleans Pelicans - Denver N.	99-105
Washington W. - Indiana Pacers	107-89
Sacramento Kings - Atlanta Hawks	135-113
Portland Trail Blazers - Utah Jazz	132-105

SHKURT

Gjeraj, lojtar i Besës

Futbollisti Robert Gjeraj është larguar nga skuadra e Lirisë së Prizrenit dhe nuk ka humbur kohë duke arritur marrëveshje me skuadrën e Besës nga Peja. Gjeraj edhe në të kaluarën ka luajtur për ekipin pejan, kurse me këtë klub synim ka inkuadrimin në IPKO Superligën e Kosovës në futboll.

Hyka "fluturon" nga Amerika në Izrael

Futbollisti shqiptar, Jahmir Hyka, do ta vazhdojë karrierën në Izrael. Futbollisti kuqezi do të lëvizë nga Amerika drejt ekipit të Makabi Netanjah, që mban vendin e pestë në renditje. Këtë lajm e ka bërë të ditur klubi izraelit në faqen e vet zyrtare në "Facebook". Detajet e kontratës nuk bëhen ende të ditura dhe ky do të jetë shteti i shatë që 30-vjeçari do të luajë, pas Norvegjisë, Greqisë, Gjermanisë, Zvicrës, Amerikës dhe normalisht Shqipërisë.

Suarezi zyrtarizohet lojtar i Arsenalit

Mesfushori i Barcelonës, Denis Suarez, ka kompletuar transferimin tek Arsenali në formë huazimi deri në fund të sezonit. 25-vjeçari do të bashkohet me trajnerin Unai Emery, me të cilin punoi sa ishin pjesë e Sevillas. Edhe pse Arsenali nuk e ka bërë të ditur, Suarezi është huazuar me të drejtë blerje nga Barcelona.

Giovinco lë Toronton për Al-Hilal

Ish-reprezentuesi i Italisë, Sebastian Giovinco, është larguar nga Toronto duke ia bashkuar zyrtarisht skuadrës Al-Hilal në Ligën profesioniste të Arabisë Saudite. Giovinco ka regjistruar 142 ndeshje dhe ka shënuar 83 gola me Toronton qëkur u largua nga Juventusi më 19 maj të vitit 2015. Ai ka fituar trofe të ndryshëm me skuadrën kanadeze, por edhe individualë.

Ozili refuzon PSG-në

Mesfushori i Arsenalit, Mesut Ozil, e ka hedhur poshtë ofertën e bërë nga skuadra franceze, Paris Saint-Germain. Kjo përpjekje e PSG-së erdhi pasi që tani është java e 10 që braziliani Neymar nuk ka arritur të rikuperohet nga lëndimet që kishte marrë. Mirëpo, pavarësisht faktit se Ozili nuk ka arritur ta bëjë më të mirën në Arsenal, ai nuk ka menduar gjatë dhe e ka hedhur ofertën e skuadrës franceze.

Autor: GAZMEND MORINA

USHQIM PREJ BRUMI TË THARË
MBISHKRIMI NË NJË GUR VARRI
LLOJ SHALE PREJ DRURI ME DY KAPTEJ TË LIDHUR ME BRINJË
ELEKTRON, TITAN
VARIOLË
ZANORE
EPOKA E RE
EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN
BIMË BARISHTORE QË KA VLERA TË MËDHA USHQIMORE
PUSI I UJIT / HISTORIANI ROMAK LUKRECI

NDODHI QË TREGOHET ME GOJË; TREGIM ME GOJË (krah.)
QË DO ZGJIDHJE TË SHPEJTË (mjek.) / POLITIKANI GAZMEND
GJENDJE PLOGËSHTIE SHPIRTËRORE
MËNYRË ARTIFICIALE E EPSHIT / SHTERPË
LËNDË MËSIMORE
GRILL (sh.shq.) / GRIMCAT MOLEKULARE
PËREMËR VETOR
ATEMATIK, JO TEMOR / AXHAMI, JO I RRITUR
VËNIE E MINAVE
RRALLËSI (Lat.)
PORTIERI HOWARD (EVERTON) / AKTORJA AMERIKANE THIESSEN
OHAJO, FLORIDA
FUTBOLLISTI ALVARO ..... (R. MADRID) / BASHKËT.
ZANORE / PADITËS I SOKRATIT
AGJËRIMI (krah.)
ZANORE / ARKA SHTETËRORE (Lat.)
AGRON NIKA / KLUB FUTBOLLI NË SPANJË

EPOKA E RE
KËNGËTARJA NË FOTO
SONDAZHI
GRACKË PËR TË ZËNË ZOGJ
PORTIERI KASILLAS
SËPATË E VOGËL (sh.shq.)
ZANORE / ELIZABETH TAYLOR
AKADEMIKU STAVILECI
MJET KOMUNIKIMI / PJESË E MISHTË E TRUPIT TË NJERIUT

E LUIHATSHME NË QËNDRIME
E TREMB / KRYEQYTETI I KANADASË
HUMORISTI ..... KIÇINA / THIKA QË MBAHEJ SI ARMË BREZI
E PËRZIER
FLEGËR / ISH FUTBOLLIST I NJOHUR BRAZILIAN
DJALL (hebr.)
GRUP I PËRBËRË PREJ TETË KËNGËTARËSH
TON, ALUMIN / MJET I THJESHTË LUNDRIMI (sh.shq.)
KRYEQYTETI EVROPIAN I MODËS / QYTET I LASHTË NË ILIRI
BASHKËT. / GJYNAH
NEON
KRYEQYTETI I MAROKUT (pashq.) / SHTET NË AZI
BAKRI / KËNGË E POPULLARI-ZUAR
AKTORJA E FAMSHME THURMAN / E FRIKËSOJ SHUMË DIKË
TRAJNERI GJERMAN REHAGEL
TANTAL, VOLT / AIR TRAVEL ORGANISERS LICENSING
MUZIKANTI ADRIAN / MICHIGAN EDUCATION ASSOCIATION
PJATAT / PUSIA
KËNGËTARJA VALENTINA
SPIKERJA ..... MURTEZI - SHALA / PRAROJ
GRUAJA E MOSHUAR / PUSULLAT
ZANORE
SULM / GJENDJE E PA PUSHTET (shq.)
FUTBOLLISTI SAMUEL ... / MOTAK
JO E VJETËR / ZANORE
ALESANDRO NESTA / SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE
PEIZAZHI I GJERË
VLERËSIM ME NOTË (sh.shq.) / VDEKJEPR-URËS
ARTI I VALLEVE ME FIGURA, QË LUHEN NË SKENË NGA DISA VETA
OLIVER NEUVILLE
LLOJ LOJE FATI / MUZIKANTI .... DHOMI
FINLANDA, ISLANDA / DY BASHKË-TINGËLLORE
I THAJ / NJËSI KOHE
BASHKËT. / QË IA PRET MENDJA; I SHKATHËT
DAFINË
BASHKËT. / KËSTI BANKAR PËR KTHIMIN E KREDISË
DIREK I ÇATISË / ZILI, INAT
VEGËL MUZIKORE / KULAÇE
KOHË E NDARË PËR PUNË
E VRARË NË LUFTË / DOCUMENTAR EDUCATIONAL RESOURCES
PARAARDHËS I ITALIANËVE
EKIP
GURRAT / DY BASHKË-TINGËLLORE
PJESË E LOJËS NË TENIS (sh.pashq.) / JEMENI, INDONEZIA
UÇK (ang. shk.) / ARSENAL
ADEM JASHARI / ZANORE
KRAHINË NË SHQIPËRI / NANTES
SHPEND GRABITQAR ME SQEP TË KTHYER E ME KTHETRA / ALI ALIU
REPERI AGUSHI
DRYNI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot Br. prot. 10 Më Dt. 30.01.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

Nr. Protokolit 01/35/19
Me Datë: 30.01.2019
Rahovec, 2019

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/2009) dhe Ndryshim Plotësimit të Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-205 të datës 10 dhjetor 2010, nenit 21, 44 dhe 108 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016) si dhe kërkesës së subjektit kërkues-Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.Prot. 105 të datës 04.10.2018 dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve brenda afatit ligjor, Kryetari i Komunës së Rahovecit merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. **SHPRONËSOHET paluajtshmëria për interes publik për ndërtimin-restaurimin e shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe, si vijon:**
   Ngastra kadastrale Nr. P-7153005-01901-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 9080 m^2 ku nga kjo sipërfaqe e përgjithshme do të ndahet pjesa e parcelës në sipërfaqe prej **178 m^2** sipas çertifikatës së pronës së paluajtshme të evidentuar në emër të pronarit Refki (Fetah) Hoti nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit.
2. **VËRTETOHET** se **"ndërtimi-restaurimi i shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe"** Komuna e Rahovec është qëllim i ligjshëm dhe me interes publik dhe se shpronësimi i paluajtshmerisë së lartëcekur është në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.
